



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2022 – Numri: 66

Tiranë – E premte, 29 prill 2022

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 874, datë 29.9.2021	Për miratimin e rregullave për zbatimin e parimeve të etikës, të klasifikimit të veprimtarive të jashtme dhe vlerën e dhuratave, që mund të pranohen gjatë veprimtarisë së nëpunësit të administratës publike..... 8493
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 875, datë 29.9.2021	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.830, datë 15.9.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Kodit Etik Ministror”..... 8502
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 252, datë 29.4.2022	Për procedurat e ofrimit të shërbimeve <i>on-line</i> nga institucionet shërbimofruese dhe për metodologjinë e monitorimit e të kontrollit të veprimtarisë administrative të ofrimit të tyre..... 8504
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 256, datë 29.4.2022	Për disa ndryshime në vendimin nr.584, datë 8.10.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për shpalljen e gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike” 8508
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 257, datë 29.4.2022	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.1299, datë 16.12.2009, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës, të organikës dhe të numrit të nëpunësve të shërbimit të gjendjes civile në bashki/njësi administrative dhe në zyrat e arkivit të gjendjes civile pranë prefektit të qarkut”, të ndryshuar..... 8508
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 258, datë 29.4.2022	Për disa ndryshime në vendimin nr.1243, datë 11.12.2009, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e dokumenteve, që duhet të paraqesin shtetasit e të procedurave, që duhet të kryejnë zyrat e gjendjes civile në bashki/njësi bashkiake/komuna dhe institucionet shtetërore, të posaçme, për ndryshimin e vendbanimit/adresës së shtetasve”..... 8511
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 259, datë 29.4.2022	Për një ndryshim në vendimin nr.928, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret, procedurat dhe dokumentacionin për pensionin social” 8512

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 260, datë 29.4.2022	Për miratimin e marrëveshjes së grantit dhe projektit të BE-së, ndërmjet Republikës së Shqipërisë (marrësi), të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe <i>KfW Frankfurt am Main</i> (KfW) dhe Korporatës Elektroenergjetike Shqiptare (KESH) (agjencia e zbatimit të projektit), rehabilitimi i hidrocentralit të Fierzës.....	8513
Vendim i Këshillit të Ministrave nr.263, datë 29.4.2022	Për miratimin e letërmarrëveshjes së grantit nr.tf0b5581, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për projektin e forcimit të cilësisë së auditimit dhe raportimit....	8523
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 265, datë 29.4.2022	Për një ndryshim në vendimin nr.548, datë 27.7.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e kriterëve, rregullave dhe të procedurave për përfitimin e pensioneve shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit”, të ndryshuar.....	8528
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 266, datë 29.4.2022	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.17, datë 15.1.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programeve të nxitjes së punësimit nëpërmjet punësimit, formimit në punë dhe praktikave profesionale”, të ndryshuar.....	8529
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 267, datë 29.4.2022	Për disa ndryshime në vendimin nr.837, datë 28.10.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për procedurat, kriteret e rregullat për ofrimin e shërbimeve të punësimit”.....	8529
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 268, datë 29.4.2022	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.453, datë 3.7.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për masën e subvencionit të interesave të kredisë dhe procedurën e dhënies së tij për familjet, që përfitojnë banesë me kosto të ulët, me kredi të lehtësuara nga shteti”.....	8530
Vendim i Këshillit të Ministrave nr.269, datë 29.4.2022	Për një ndryshim në vendimin nr.53, datë 29.1.2004, të Këshillit të Ministrave, “Për procedurat dhe masën e trajtimit të veçantë financiar të pilotëve fluturues në pension”.....	8534
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 270, datë 29.4.2022	Për disa ndryshime në vendimin nr.535, datë 8.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programit të punëve publike në komunitet”.....	8534
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 271, datë 29.4.2022	Për një ndryshim në vendimin nr.505, datë 10.6.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për organizimin, funksionimin dhe shpërblimin e komisioneve eprorë të caktimit të aftësisë për punë”.....	8534
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 272, datë 29.4.2022	Për një ndryshim në vendimin nr.651, datë 14.9.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për zbatimin e ligjit nr.10139, datë 15.5.2009, “Për pensionet shtetërore suplementare të punonjësve të universiteteve, të shkollave të larta, Qendrës së Studimeve Albanologjike, Akademisë së Shkencave dhe të gjitha institucioneve të tjera kërkimore publike në Republikën e Shqipërisë, të cilët kanë tituj shkencorë”, të ndryshuar”.....	8535

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 274, datë 29.4.2022	Për një ndryshim në vendimin nr.477, datë 25.7.2012, të Këshillit të Ministrave, “Për procedurat dhe masën e trajtimit të veçantë financiar të pilotëve dhe teknikëve fluturues me helikopter, në pension, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe Gardën e Republikës”	8535
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 275, datë 29.4.2022	Për një ndryshim në vendimin nr.644, datë 16.6.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurës dhe të masës së trajtimit të veçantë financiar të pilotëve e të teknikëve fluturues të njësisë së transportit mjekësor me helikopter, në pension”	8536
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 276, datë 29.4.2022	Për disa ndryshime në vendimin nr.721, datë 11.11.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e dokumentacionit, shumës vjetore të transfertës nga buxheti i shtetit dhe procedurave të financimit të fondit të sigurimeve shoqërore për trajtimin financiar suplementar të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë, të punonjësve të industrisë së naftës e të gazit dhe të punonjësve që kanë punuar në metalurgji”	8536
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 277, datë 29.4.2022	Për një ndryshim në vendimin nr.793, datë 24.9.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për zbatimin e ligjit nr.10142, datë 15.5.2009, “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit e të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.....	8537



VENDIM
Nr. 874, datë 29.9.2021

**PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE
PËR ZBATIMIN E PARIMEVE TË
ETIKËS, TË KLASIFIKIMIT TË
VEPRIMTARIVE TË JASHTME DHE
VLERËN E DHURATAVE, QË MUND TË
PRANOHEN GJATË VEPRIMTARISË
SË NËPUNËSIT TË ADMINISTRATËS
PUBLIKE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, 7 e 11, të ligjit nr.9131, datë 8.9.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullave për zbatimin e parimeve të etikës, të klasifikimit të veprimtarive të jashtme dhe vlerën e dhuratave, që mund të pranohen gjatë veprimtarisë së nëpunësit të administratës publike, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Vendimi nr.714, datë 22.10.2004, i Këshillit të Ministrave, “Për veprimtarinë e jashtme dhe dhënien e dhuratave gjatë veprimtarisë së nëpunësit në administratën publike”, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

**RREGULLAT PËR ZBATIMIN E
PARIMEVE TË ETIKËS, TË
KLASIFIKIMIT TË VEPRIMTARIVE TË
JASHTME DHE VLERËN E
DHURATAVE, QË MUND TË
PRANOHEN GJATË VEPRIMTARISË SË
NËPUNËSIT TË ADMINISTRATËS
PUBLIKE**

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Objekti i këtij vendimi është përcaktimi i:

a) rregullave për zbatimin e parimeve dhe standardeve të sjelljes etike nga nëpunësit e

administratës publike, gjatë ushtrimit të detyrave me integritet, korrektësi, objektivitet, efektivitet, paanshmëri, profesionalizëm, transparencë, ndershmëri, në respektim të parimit të proporcionalitetit e barazisë, në shërbim të interesit publik;

b) rregullave të klasifikimit të një veprimtarie të jashtme si të lejueshme ose jo;

c) vlerës së dhuratave që mund të pranohen nga nëpunësi dhe të mënyrës së administrimit të dhuratave që mund të kthehen.

Neni 2
Fusha e veprimit

1. Dispozitat e këtij vendimi janë të detyrueshme për të gjithë nëpunësit e institucioneve të administratës publike, si dhe të subjekteve private, që u është dhënë e drejta e ushtrimit të funksioneve, detyrave ose kompetencave publike, me përjashtim të rasteve kur, me legjislacion të veçantë, parashikohet një rregullim i ndryshëm etik.

2. Për çështjet etike që nuk rregullohen në këtë vendim, nëpunësi i administratës publike duhet t’u referohet parimeve të përgjithshme të etikës, sipas legjislacionit në fuqi, si dhe rregulloreve të brendshme.

Neni 3
Përkufizime

Në kuptim të këtij vendimi, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) **“Nëpunës i administratës publike”**, nëpunësi i punësuar në institucionet e administratës publike, si dhe në çdo person fizik ose juridik, që i është dhënë, me ligj, akt nënligjor ose çdo lloj forme tjetër të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, e drejta e ushtrimit të kompetencave/funksioneve administrative publike;

b) **“Institucione të administratës publike”**, institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura, njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe ndërmarrjet apo shoqëritë tregtare që zotërohen tërësisht apo pjesërisht apo administrohen nga shteti;

c) **“Epror direkt”** për:

i. nëpunësit civilë – eprori i caktuar si i tillë, në respektim të legjislacionit për nëpunësin civil;



ii. nëpunësit e tjerë të institucioneve të administratës publike jashtë shërbimit civil – eprori i caktuar si i tillë në përshkrimet e punës, në respektim të ligjeve të posaçme apo të akteve nënligjore që përcaktojnë strukturën dhe organikën e institucionit;

iii. nëpunësit e subjekteve private që u është dhënë e drejta për të ushtruar funksione, detyra ose kompetenca publike – eprori i caktuar sipas legjislacionit, që rregullon marrëdhëniet e punës, kontratës kolektive, kontratës individuale, strukturës së brendshme dhe rregullores përkatëse.

ç) **“Konflikt interesi”** dhe **“interes privat”**, i njëjti kuptim sipas

legjislacionit në fuqi në këtë fushë;

d) **“Veprimtari e jashtme”**, i njëjti kuptim me atë të përcaktuar në ligjin nr.9131, datë 8.9.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”;

dh) **“Dhurata”**, likuiditete në para në dorë, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari a në huadhënie, sende me vlerë dhe çdo send apo shërbim, me vlerë monetare, të premtuar, ofruar, dhënë falas ose nën vlerën e tregut, interesat, aksionet dhe pjesët e kapitalit në shoqëri tregtare, borxhet e detyrimet jozyrtare ndaj personave fizikë apo juridikë;

e) **“Njësia e burimeve njerëzore”**, njësia përgjegjëse për menaxhimin e zhvillimin e burimeve njerëzore në institucionet/subjektet e përcaktuara sipas shkronjave “a” dhe “b”, të këtij neni;

ë) **“Procedurë disiplinore”**, e gjithë veprimtaria administrative, që kryhet që nga momenti i konstatimit të një shkeljeje disiplinore, vënies në dijeni, me shkrim, të personit që pretendohet se ka kryer shkeljen, deri në marrjen e një vendimi përfundimtar nga organi disiplinor;

f) **“Informacion konfidencial”**, informacioni, që mund të aksesohet vetëm nga personat e autorizuar sipas legjislacionit në fuqi për informacionin e klasifikuar, përhapja e të cilit mund t'i sjellë dëme sigurisë kombëtare, institucioneve/ enteve publike etj.

KREU II

RREGULLAT PËR ZBATIMIN E PARIMEVE TË ETIKËS

Neni 4

Kryerja e detyrave në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe në mënyrë të pavarur nga pikëpamja politike

Në respektim të parimit të kryerjes së detyrave, në përputhje me legjislacionin në fuqi në mënyrë të pavarur nga pikëpamja politike, dhe të mospengimit të zbatimit të politikave, vendimeve ose veprimeve ligjore të institucioneve të administratës publike, nëpunësi i administratës publike ka detyrimin të ndjekë e të zbatojë këto rregulla:

a) Gjatë ushtrimit të detyrave funksionale, nëpunësi i administratës publike zbaton me korrektësi e bindje ligjin e politikave të përgjithshme shtetërore, respekton ndarjen e kompetencave, si dhe vepron në mbrojtje të interesit publik;

b) Nëpunësi i administratës publike ushtron detyrat funksionale, duke garantuar të drejtat e liritë themelore të njeriut dhe trajtim të barabartë përpara ligjit, në përputhje me legjislacionin në fuqi;

c) Nëpunësi i administratës publike merr masat e nevojshme për parandalimin e veprimeve të paligjshme dhe ka detyrimin të informojë eprorët, si dhe të adresojë pranë autoriteteve kompetente çdo rast abuzimi, vjedhjeje, mashtrimi dhe korrupsioni apo vepra të tjera, që mund të konstatojë gjatë ushtrimit të detyrës;

ç) Nëse nëpunësi i administratës publike dyshon se eprori ka dhënë një urdhër të paligjshëm, informon pa vonesë eprorin e personit, që ka dhënë këtë urdhër dhe kërkon konfirmimin e tij me shkrim. Ai ka detyrimin ta zbatojë urdhrin me shkrim, me përjashtim të rastit kur zbatimi i tij përbën veprë penale;

d) Në varësi të pozicionit të punës, nëpunësi i administratës publike mund të jetë anëtar i partive politike apo i grupeve me karakter politik, për aq sa lejohet me ligj;

dh) Nëpunësi i administratës publike lejohet të marrë pjesë në grumbullime, takime, mbledhje, tubime me karakter politik apo të shprehë publikisht bindjet apo preferencat politike, për aq sa nuk bie ndesh me legjislacionin në fuqi;



e) Nëpunësi i administratës publike distancohet qartazi nga çdo ndikim ose presion politik, që mund të çojë në njëanshmëri gjatë përmbushjes së detyrave.

Neni 5

Kryerja e detyrave me ndershmëri, paanshmëri, efikasitet, ruajtja dhe rritja e besimit të publikut

Në respektim të parimit të kryerjes së detyrave me ndershmëri, paanshmëri, efikasitet, duke pasur parasysh vetëm interesin publik dhe me qëllim që sjellja e tij t'i shërbejë ruajtjes dhe rritjes së besimit të publikut në ndershmërinë, paanshmërinë dhe efektivitetin e shërbimit publik, nëpunësi i administratës publike ka detyrimin të ndjekë dhe të zbatojë këto rregulla:

a) Në çdo rast, nëpunësi i administratës publike vepron me integritet të lartë moral e profesional, në funksion të kryerjes së veprimtarisë administrative;

b) Sjellja personale e nëpunësit të administratës publike duhet të jetë e tillë që të reflektojë ndershmëri, të promovojë vlerat e parimet më të larta etiko-morale dhe të inkurajojë nëpunësit e tjerë të veprojnë në përputhje me këto vlera;

c) Nëpunësi i administratës publike duhet të jetë i paanshëm, i besueshëm, transparent, efektiv, duke realizuar me disiplinë dhe në kohë detyrat funksionale, në respektim të interesit publik;

ç) Nëpunësi i administratës publike përdor në mënyrë efektive kohën e punës për realizimin me përgjegjësi dhe korrektësi të detyrave funksionale, duke kontribuar në rritjen e performancës së administratës;

d) Gjatë ushtrimit të detyrës, nëpunësi i administratës publike:

i. ndjek e zbaton parimin e deburokratizimit e të eficiencës, duke siguruar që procedura administrative të zhvillohet sa më shpejt të jetë e mundur, brenda afateve ligjore dhe me sa më pak kosto;

ii. jep mendime dhe opinione objektive, bazuar në dijeninë dhe në përvojën profesionale, duke garantuar paprekshmërinë e interesit publik e institucional, mbi atë personal.

dh) Nëpunësi i administratës publike realizon në kohë dhe me përgjegjësi detyrat, duke mos hequr dorë nga kompetencat gjatë vendimarrjes. Çdo vonesë në përmbushjen e detyrave duhet të jetë e

arsyetuar. Ngarkimi i detyrave duhet të jetë në përputhje me legjislacionin në fuqi;

e) Në përmbushje të detyrave funksionale, nëpunësi i administratës publike ndjek e përgatit çështjet që i janë ngarkuar sipas rëndësisë, prioriteteve dhe/ose rendit kronologjik;

ë) Nëpunësi i administratës publike shqyrton me vëmendjen e duhur të gjitha kërkesat e individëve dhe mundëson përgjigjet respektive ndaj tyre. Çështjet që nëpunësi i administratës publike, në bashkëpunim me eprorin, i vlerëson jashtë kompetencës së vet, i përcjell pa vonesë tek institucioni kompetent, duke vënë në dijeni, në çdo rast, edhe kërkuuesin.

Neni 6

Konflikti i interesit e respektimi i të drejtave dhe interesave personalë të të tretëve

Në respektim të parimit të moslejimit që interesat privatë të bien ndesh me pozitën e tij publike, shmangies së konfliktit të interesave, mosshfrytëzimit të pozitës për interesin privat, moskryerjes së veprimeve arbitrare dhe tregimit të respektit të duhur për të drejtat e interesat personalë të të tretëve, nëpunësi i administratës publike ka detyrimin të ndjekë dhe zbatojë këto rregulla:

a) Nëpunësi i administratës publike shmang çdo situatë të konfliktit të interesit gjatë përmbushjes së detyrave, deklaron interesat privatë pranë autoritetit përgjegjës të institucionit dhe respekton dispozitat e legjislacionit për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike;

b) Nëpunësi i administratës publike duhet të shmangë angazhimin në aktivitete që përbëjnë, mund të përbëjnë apo do të përbëjnë konflikt interesi të çdo lloji, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për konfliktin e interesit;

c) Nëpunësi i administratës publike duhet të shmangë situata, veprime dhe sjellje që dëmtojnë apo mund të dëmtojnë imazhin e administratës publike. Përbëjnë cenim të imazhit të administratës publike, por pa u kufizuar në to:

i. shoqërimi me persona privatë, që mund të kenë interesa në/të lidhura me veprimtarinë e institucioneve/subjekteve të përcaktuara, sipas shkronjave “a” dhe “b”, të nenit 3, të këtij vendimi, apo shoqërimi me persona privatë të përfshirë në aktivitete të paligjshme;



ii. kryerja e veprimeve të ekzagjeruara në bare, lokale, restorante, parqe dhe/apo ambiente të tjera publike;

iii. frekuentimi i ambienteve, aktiviteteve apo vendeve të padenja dhe që mund të dëmtojnë ose të hedhin dyshime mbi figurën e tij morale;

iv. përdorimi në mënyrë jokorrekte i medias dhe i rrjeteve sociale;

v. realizimi dhe publikimi në çfarëdolloj forme i fotove/videove të vetvetes, kolegëve, ambienteve të punës, proceseve të punës, për qëllime që nuk lidhen me punën apo me aktivitete zyrtare.

ç) Në marrëdhëniet me publikun, gjatë një procedure administrative, nëpunësi i administratës publike garanton respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të personave të përfshirë në të, në mënyrë sa më efektive. Ai i informon palët mbi të drejtat e detyrimit e tyre dhe i paralajmëron ato për pasojat ligjore të veprimeve ose të mosveprimeve të tyre.

Neni 7

Përdorimi i informacionit zyrtar dhe ruajtja e konfidencialitetit të tij

1. Në respektim të parimit të ruajtjes së konfidencialitetit të informacionit që ka në zotërim dhe të përdorimit të këtij informacioni, në përputhje me legjislacionin për të drejtën e informimit, nëpunësi i administratës publike ka detyrimin të ndjekë dhe të zbatojë këto rregulla:

a) Nëpunësi i administratës publike garanton dhënien e informacionit publikut, në përputhje me parashikimet e legjislacionit për të drejtën e informimit, për aq kohë sa ky informacion nuk është i ndaluar për t'u dhënë;

b) Nëpunësi i administratës publike ruan konfidencialitetin e informacionit që zotëron, por pa cenuar zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga legjislacioni që rregullon të drejtën e informimit mbi dokumentet zyrtare;

c) Nëpunësi i administratës publike nuk mund të përdorë për qëllime private informacionin që zotëron për shkak të detyrës;

ç) Nëpunësi i administratës publike mbron, ruan e nuk përhap informacionin zyrtar edhe pas largimit nga detyra, për një periudhë 2-vjeçare. Në rastet e informacionit konfidencial, afati përcaktohet sipas legjislacionit në fuqi;

d) Publikimi dhe transmetimi nga nëpunësi i administratës publike, përmes mjeteve të ndryshme

të komunikimit, i kujtimeve personale që lidhen me detyrën që ka ushtruar ose ushtron duhet të jetë gjithnjë në përputhje me parimin e konfidencialitetit;

dh) Nëpunësi i administratës publike nuk mund të shpërndajë apo të publikojë dokumentacionin zyrtar, që administrohet në institucionet/subjektet e përcaktuara sipas shkronjave “a” dhe “b”, të nenit 3, të këtij vendimi, pa autorizimin paraprak të eprorëve, me përjashtim të materialeve që publikohen në faqen elektronike, në kuadër të programit të transparencës.

2. Ish-nëpunësi i administratës publike nuk duhet të përfaqësojë asnjë person ose organizatë në një konflikt ose marrëdhënie tregtare me administratën publike shqiptare, për një periudhë kohe 2-vjeçare pas largimit nga detyra, për detyrën që ai ka kryer ose në vazhdimësi të saj.

3. Në rast të fillimit të një detyre të re brenda afatit 2-vjeçar të përcaktuar në pikën 2, të këtij neni, ish-nëpunësi duhet të informojë njësinë e burimeve njerëzore të institucionit, ku ka qenë i punësuar, minimalisht 2 (dy) javë përpara fillimit të detyrës, për qëllimin e tij për t'u angazhuar në një marrëdhënie tjetër punësimi.

4. Njësia e burimeve njerëzore shqyrton informacionin e dhënë për të përcaktuar nëse natyra e veprimtarisë është apo jo në kushtet e përcaktuara në pikën 2, të këtij neni, dhe njofton me shkrim nëpunësin për vendimin e saj, brenda 5 (pesë) ditëve pune nga marrja e kërkesës nga nëpunësi.

5. Nuk ka nevojë të raportohen veprimtaritë që kanë të bëjnë me:

a) aktivitete bamirësie ose humanitare;

b) aktivitetet që rrjedhin nga bindjet politike, sindikaliste dhe/ose filozofike ose fetare;

c) aktivitetet kulturore;

ç) menaxhimin e thjeshtë të aseteve apo zotërimeve apo pasurisë personale apo familjare, në cilësinë private;

d) veprimtarinë akademike;

dh) punësimin në administratën publike;

e) aktivitete të ngjashme.

6. Për situata apo raste tepër të dyshimta dhe të patrajtuara më parë, njësia e burimeve njerëzore mund të kërkojë ndihmën e Departamentit të Administratës Publike.



Neni 8

Sjellja në marrëdhënie me qytetarët, eprorët, kolegët e vartësit

Në respektim të parimit të sjelljes etike në marrëdhënie me qytetarët, eprorët, kolegët dhe vartësit, nëpunësi i administratës publike ka detyrimin të ndjekë dhe të zbatojë këto rregulla:

a) Komunikimi i nëpunësit të administratës publike duhet të karakterizohet nga etika, mirësjellja dhe respekti i ndërsjellë. Komunikimi verbal dhe joverbal (gjuha e trupit, gjestikulacioni, toni i zërit, mënyra e vështimit, ruajtja e distancës fizike etj.) duhet të jetë korrekte, pa përdorur fjalor fyes apo paragjykses, për çfarëdolloj arsyeje apo shkak. Në mjediset e punës nuk mund të komunikohet me zë të lartë apo të përdoren shprehje të papërshtatshme.

b) Eprori nxit zhvillimin profesional të nëpunësve të administratës publike në mënyrë të paanshme e gjithëpërfshirëse, përmes ofrimit të mundësive për kualifikim dhe ecuri të vazhdueshme në karrierë;

c) Nëpunësve të punësuar rishtazi në institucionet e administratës publike duhet t'u krijohen kushtet e përshtatshme për ushtrimin sa më efektiv të detyrës, duke u dhënë ndihmën e duhur përmes këshillimit, orientimit, shkëmbimit të informacionit, me qëllim aftësimin e përshtatjen e tyre në institucionin ku janë të punësuar.

ç) Nëpunësi i administratës publike respekton rregullat e procedurat lidhur me komunikimin e brendshëm zyrtar, me shkrim, me mjete elektronike apo verbal, duke respektuar hierarkinë dhe llogaridhënien. Rregulla më të detajuara për komunikimet e brendshme parashikohen në rregulloret përkatëse.

d) Paraqitja dhe veshja e nëpunësit të administratës publike duhet të jetë e denjë dhe serioze, në përshtatje me funksionin që kryen. Veshja duhet të përmbushë standardet e profesionalizmit dhe modestisë, duke shmangur kështu krijimin e përshtypjes së pahijshme dhe dëmtimin e imazhit të administratës publike. Rregulla më të detajuara për veshjen përcaktohen në rregulloret e brendshme përkatëse.

dh) Hyrja dhe dalja në ambientet e vendit të punës nga nëpunësi i administratës publike kryhet në përputhje me orarin zyrtar të përcaktuar në legjislacionin në fuqi, me përjashtim të rasteve kur,

për arsye objektive, autorizohet ndryshe nga titullari;

e) Brenda orarit zyrtar të punës, nëpunësi i administratës publike nuk duhet të frekuentojë ambiente të ndryshme nga ai i punës, me përjashtim të rasteve të kushtëzuara nga ushtrimi i detyrave funksionale;

ë) Nëpunësi i administratës publike mund të përdorë telefonin celular privat kur nuk pengon kryerjen e detyrave. Përdorimi i tyre gjatë takimeve dhe mbledhjeve të punës është i ndaluar.

f) Telefoni celular zyrtar duhet të përdoret nga nëpunësi i administratës publike vetëm për arsye pune. Ai është i detyruar ta mbajë hapur atë brenda orarit zyrtar dhe gjatë ushtrimit të detyrave, me qëllim mbajtjen e komunikimit të pandërprerë.

g) Nëpunësi i administratës publike që merr pjesë në një aktivitet, mbledhje apo takim pune, konferencë etj. jashtë vendit apo jashtë qytetit ku ndodhet qendra e tij e punës, informon me shkrim eprorin direkt, titullarin e institucionit dhe njësinë e burimeve njerëzore në rrugë protokollare;

gj) Përpara zhvillimit të vizitave zyrtare dhe të punës jashtë shtetit, nëpunësi i administratës publike merr miratimin paraprak të titullarit të institucionit apo të personit të autorizuar prej tij e njofton ministrinë përgjegjëse për punët e jashtme;

h) Nëpunësi i administratës publike, në zbatim të detyrimit të ruajtjes e të mbrojtjes së pronës, mjeteve të punës, pajisjeve dhe mallrave në administrim të institucionit, si dhe të dokumentacionit zyrtar, merr masat për përdorimin e tyre vetëm për qëllime zyrtare. Në rast të keqfunksionimit të mjeteve të inventarit dhe/ose të zyrës, duhet të njoftojë menjëherë eprorin e tij dhe njësinë e shërbimeve mbështetëse.

KREU III

**PËRCAKTIME TË VEÇANTA PËR
TITULLARËT E INSTITUCIONEVE TË
ADMINISTRATËS PUBLIKE**

Neni 9

1. Përveç sa është përcaktuar në krerët I, II, IV, V e VI, të këtij vendimi, dhe/ose legjislacion tjetër specifik në fuqi, titullarët e institucioneve të administratës publike u nënshtrohen edhe dispozitave të këtij kreu.



2. Titullari i institucionit të administratës publike realizon me ndershmëri dhe përpikëri objektivat e ngarkuar nëpërmjet sjelljes së duhur organizative, shfaq sjellje të përshtatshme dhe të paanshme, duke shërbyer si model për nëpunësit, si dhe nxit zbatimin e standardeve më të larta në administratën publike.

3. Titullari i institucionit të administratës publike:

a) kujdeset që burimet, përfshirë ato njerëzore dhe financiare, që administrojnë për shkak të detyrës, të përdoren vetëm për qëllimet për të cilat janë vënë në dispozicion, në funksion të realizimit të interesit publik dhe në asnjë rast për interesa personale;

b) siguron që fondet e buxhetit të shtetit të mos përdoren për organizimin e festave për nëpunësit e institucionit;

c) siguron menaxhim efektiv e të përshtatshëm të institucionit që drejton, përmes vendosjes së marrëdhënieve korrekte me vartësit dhe bashkëpunëtorët;

ç) bën ndarje të përshtatshme dhe të duhur të detyrave, në funksion të menaxhimit efektiv të institucionit.

4. Në rast se titullari i institucionit të administratës publike bie në dijeni të një situate paligjshmërie, që përbën shkelje disiplinore, ai ndërmerri masat e nevojshme administrative, duke e referuar çështjen pranë komisionit disiplinor. Në rast se bie në dijeni të një veprë penale, ai adreson çështjen pranë organeve kompetente pa vonesë.

5. Titullari i institucionit të administratës publike:

a) merr masa për mosshpërndarjen e informacioneve, lajmeve të pasakta dhe të pavërteta për organizimin, veprimtarinë, funksionimin apo nëpunësit e institucionit që drejton;

b) ofron, zbaton e shpërndan praktikën më të mira administrative, me qëllim rritjen e besimit të qytetarëve në institucionet publike.

6. Titullari i institucionit të administratës publike nuk mund të ushtrojë detyra të tjera të papajtueshme me funksionin publik që mban, si dhe aktivitete që ulin performancën e institucionit që drejton.

7. Titullari i institucionit të administratës publike nuk mund të japë deklarata apo të shfaqë publikisht mendime dhe opinione, që bien ndesh me politikat e përgjithshme shtetërore.

8. Përpara marrjes së detyrës, titullari i institucionit të administratës publike i njofton njësisë përgjegjëse interesat privatë, që mund të përbëjnë shkak për konflikt interesash. Ai zbaton e ndjek me përpikëri legjislacionin në fuqi.

9. Përpara zhvillimit të vizitave zyrtare dhe të punës jashtë shtetit, titullari i institucionit të administratës publike merr miratimin paraprak sipas procedurave të parashikuara nga legjislacioni në fuqi.

10. Dispozitat e këtij kreu zbatohen edhe për personin zëvendësues të titullarit.

KREU IV RREGULLAT E KLASIFIKIMIT TË VEPRIMTARIVE TË JASHTME

Neni 10

1. Veprimtaritë e jashtme të nëpunësit të institucioneve të administratës publike janë të lejueshme vetëm kur nuk bëhen pengesë për përmbushjen e detyrave dhe të përgjegjësisë zyrtare.

2. Nëpunësi i institucioneve të administratës publike nuk mund të angazhohet në një veprimtari të jashtme, nëse:

a) ajo krijon ose duket sikur krijon një konflikt interesash me pozicionin e tij zyrtar;

b) angazhimi mendor e fizik i nëpunësit në këtë veprimtari ndikon në kryerjen normale të detyrave të tij zyrtare, pengon ose e bën të vështirë kryerjen e tyre;

c) veprimtaria që kryen cenon figurën e tij ose të institucionit të administratës publike, ku ai është i punësuar;

ç) veprimtaria që kryen është vazhdim i detyrave të tij zyrtare dhe nëpunësi duhet të përdorë të dhënat që ka nga pozicioni i tij;

d) qëllimi i veprimtarisë bie në kundërshtim me qëllimin dhe objektivat e pozicionit zyrtar të punës;

dh) është një veprimtari, që kryhet me kohë të plotë.

3. Nuk konsiderohet si veprimtari e jashtme e palejueshme veprimtaria në kuadër të shoqatave kulturore, shoqërore apo sportive, pjesëmarrja në organet drejtuese të këtyre shoqatave, me përjashtim të rasteve kur kjo ndalohej shprehimisht nga ligji dhe/ose kur ajo pengon kryerjen normale të detyrës zyrtare.



4. Në mungesë të një autorizimi, nëpunësi nuk duhet të dëshmojë si ekspert përpara ndonjë trupi gjykyes apo të përfaqësojë ndonjë person fizik ose juridik, vendas apo të huaj, organizatë, entitet apo qeveri të huaj, nëse institucionet e administratës publike janë palë apo kanë ndonjë interes të drejtpërdrejtë dhe të rëndësishëm në çështjen që shqyrtohet.

5. Nëpunësi i administratës publike njofton zyrtarisht eprorin direkt dhe njësinë e burimeve njerëzore të institucionit për veprimtarinë e jashtme që do të kryejë, duke bërë një përshkrim të shkurtër të veprimtarisë, të objektivave dhe qëllimeve të organizatës, për të cilën kryen veprimtarinë e jashtme.

6. Mbështetur në të dhënat e marra, eprori direkt, në bashkëpunim me njësinë e burimeve njerëzore të institucionit, verifikon nëse veprimtaria që do të kryejë nëpunësi kategorizohet si e lejueshme sipas këtij vendimi. Eprori direkt merr vendimin për përcaktimin e veprimtarisë së jashtme si të lejueshme apo jo dhe ia komunikon atë, me shkrim, nëpunësit kërkuar.

7. Ndaj vendimit të eprorit direkt mund të bëhet ankim pranë titullarit të institucionit, i cili merr vendim të arsyetuar.

8. Në rastet kur nëpunësi i institucioneve të administratës publike, me miratimin e titullarit/eprorit, kryen veprimtari mësimdhënieje apo trajnuese gjatë orarit zyrtar, ai është i detyruar të kompensojë orët e punës brenda javës, pas orarit zyrtar të punës.

9. Kur nëpunësi kryen veprimtari të jashtme përpara fillimit të marrëdhënieve të punës, në çastin e punësimit ai njofton me shkrim eprorin direkt dhe njësinë e burimeve njerëzore dhe merr miratimin e tyre sipas përcaktimeve në këtë kre, për të vijuar me ushtrimin e veprimtarisë së jashtme.

KREU V DHURATAT DHE FAVORET

Neni 11

1. Nëpunësi i administratës publike nuk duhet të kërkojë apo të pranojë, në mënyrë të drejtpërdrejtë a të tërthortë, për veten, familjen, të afërmit, personat fizikë apo juridikë me të cilët ka marrëdhënie:

a) dhurata, favore, pritje apo çdo përfitim tjetër, si dhe premtime për to, të cilat i jepen për shkak të pozicionit të tij, me efekt përfitimi të çfarëdoshëm për dhuruesin ose persona të tretë, që ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në paanshmërinë e kryerjes së detyrës, a janë ose duket sikur janë shpërblim për mënyrën e kryerjes së detyrës;

b) ftesa për pritje të ndryshme, premtime, ofrime falas apo ulje të çmimeve për kryerjen e shërbimeve, të argëtimeve, pushimeve, transporteve, udhëtimeve;

c) përfitime të bursave të studimit dhe/apo të sigurimeve.

2. Nëpunësi i administratës publike nuk duhet të kërkojë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, të japë dhurata ose të ndërmjetësojë për të dhënë dhurata për një nëpunës të një niveli më të lartë apo të afërm të tij dhe as të kërkojë ose të pranojë dhurata nga nëpunës i një niveli më të ulët ose të afërm të tij, për shkak të cilësive dhe raporteve zyrtare.

3. Një dhuratë konsiderohet e marrë në mënyrë të tërthortë kur i jepet familjes së nëpunësit, të afërmeve, deri në shkallën e dytë, personave ose organizatave, me të cilat nëpunësi ka pasur ose ka marrëdhënie biznesi ose lidhje politike, në bazë të kërkesës, rekomandimit apo udhëzimit të nëpunësit.

4. Rregullat e përcaktuara në pikat 1, 2 dhe 3, të këtij neni, nuk zbatohen në rastin e ftesave të zakonshme apo kur janë të ftuar nëpunës ose kolegë të tjerë, të mikpritjes tradicionale, dhuratave me vlerë simbolike apo tradicionale dhe të mirësjelljes, brenda kufijve normalë të traditës, zakoneve, lidhjes fafëfisnore dhe praktikës së përditshme, të cilat nuk krijojnë dyshime për paanësinë e nëpunësit.

5. Nëpunësi i administratës publike mund të pranojë dhurata nga qeveritë e huaja apo organizatat ndërkombëtare, brenda kufijve normalë të shprehjes së mikpritjes dhe trajtimit që buron prej saj, kortezisë apo protokollit, nëse nuk tejkalohen kufijtë e traditës e të zakoneve të vendit ku jepen, nuk vënë në dyshim objektivitetin, ndershmërinë dhe paanshmërinë e nëpunësit e nëse nuk kompromentojnë imazhin dhe integritetin e Republikës së Shqipërisë.

6. Nëpunësi i administratës publike mund të mbajë dhurata të lejueshme, pa qenë i detyruar t'i deklarojë ato, nëse nuk e kalojnë vlerën prej 10 000



(dhjetë mijë) lekësh për dhuratë. Nëse nëpunësi ka dyshim për vlerën e dhuratës, ai njofton eprorin direkt dhe i kërkon njësisë së burimeve njerëzore të kryejë vlerësimin e saj.

7. Dhuratat e pranuar nga nëpunësi i administratës publike nga delegacione të çfarëdo natyre apo individë, mbi vlerën e caktuar, për shkak të pozicionit të tij, duhet të deklarohen brenda 30 (tridhjetë) ditëve tek eprorët, si dhe në njësinë e shërbimeve mbështetëse.

8. Njësia e burimeve njerëzore bën vlerësimin e dhuratave dhe inventarizon ato me vlerë më të madhe se 10 000 (dhjetë mijë) lekë. Dhuratat administrohen në një vend të posaçëm dhe ato mund të përdoren për qëllime të veprimtarisë institucionale.

9. Dhuratat, që kanë vlera artistike, muzeore apo historike, u dorëzohen institucioneve të specializuara.

10. Në të njëjtën mënyrë administrohen edhe dhuratat që nuk mund të kthehen, sipas ligjit nr.9131, datë 8.9.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”.

11. Në asnjë rast, nëpunësi nuk duhet të pranojë dhurata në vlerë monetare.

12. Në rast se nëpunësi i administratës publike dëshiron të mbajë dhuratën me vlerë mbi 10 000 (dhjetë mijë) lekë, atëherë ai paguan diferencën e vlerës së saj, pas vlerësimit të bërë nga institucioni.

13. Janë të ndaluara të gjitha dhuratat, që çojnë në konflikt interesi sipas legjislacionit në këtë fushë, pavarësisht vlerës së tyre.

14. Nëpunësi i administratës publike nuk merr përsipër dhe as bën premtime, lidhur me kryerjen ose moskryerjen e veprimeve administrative në kompetencë të tij ose të kolegëve, që mund të përbëjnë shkak për njëanshmëri gjatë ushtrimit të detyrave.

KREU VI KËSHILLIMI, TRAJNIMI, MBIKËQYRJA DHE DISIPLINA PËR ZBATIMIN E RREGULLAVE TË ETIKËS

Neni 12 Këshillimi dhe informimi

1. Njësia e burimeve njerëzore është përgjegjëse për këshillimin e çdo nëpunësi të administratës

publike për detyrimet që burojnë nga legjislacioni në fuqi për standardet e sjelljes etike.

2. Këshillimi për standardet e sjelljes etike ofrohet nga njësia e burimeve njerëzore:

a) në momentin e fillimit të punës, përmes njohjes me legjislacionin përkatës në fuqi, si dhe manualeve apo fletëpalosjeve të përgatitura për etikën;

b) gjatë ushtrimit të detyrës, përmes formimit profesional/trajnimeve të planifikuara;

c) rast pas rasti, mbi bazën e kërkesës së nëpunësit.

3. Me qëllim mbajtjen të informuar të nëpunësve të administratës publike, Departamenti i Administratës Publike dhe njësitë e burimeve njerëzore realizojnë këshillime dhe informime periodike për çështje të rregullave të etikës.

4. Informimi dhe këshillimi periodik realizohet:

a) nëpërmjet *e-mail*-eve informuese, mbledhjeve dhe/apo sesioneve të shkurtra, me qëllim përditësimin e nëpunësve për situata apo raste që kanë të bëjnë me rregullat e etikës;

b) mbi bazën e rasteve konkrete, nga praktika administrative në Shqipëri, në vende të tjera apo në organizata ndërkombëtare. Këto raste mund të jepen në mënyrë individuale apo si përgjithësim i praktikës administrative.

5. Për realizimin e procesit të informimit dhe këshillimit periodik, Departamenti i Administratës Publike:

a) u dërgon në mënyrë periodike *e-mail*-e informuese njësisë së burimeve njerëzore të çdo institucioni raste dhe situata që përfshijnë zbatimin e rregullave të etikës e mënyrën e zgjidhjes së tyre, me udhëzimin për t’ua shpërndarë nëpunësve të atij institucioni ose realizimin e sesioneve të shkurtra informuese;

b) realizon me përfaqësues të burimeve njerëzore të institucioneve të administratës publike, në mënyrë periodike, sesione trajnuese për problematikën e shfaqura në lidhje me rregullat e etikës, zgjidhjen e tyre dhe mënyrën e transmetimit të tyre te nëpunësit e çdo institucioni.

6. Departamenti i Administratës Publike dhe njësitë e burimeve njerëzore kujdesen që, gjatë procesit të informimit dhe këshillimit periodik, të dhënat të jepen në mënyrë të anonimizuar, duke shmangur identifikimin e nëpunësve, si edhe të institucioneve të përfshira në këtë proces.



7. Njësitë e burimeve njerëzore raportojnë në mënyrë periodike, në Departamentin e Administratës Publike, rastet e situatat që kanë të bëjnë me mënyrën e zbatimit të rregullave të etikës, si edhe zgjidhjen e dhënë.

8. Njësia e burimeve njerëzore, për raste të veçanta, këshillohet edhe me Departamentin e Administratës Publike.

9. Në rast se nëpunësi i administratës publike, gjatë realizimit të detyrave të tij funksionale ka dyshime se sjellja, veprimi dhe/apo mosveprimi i tij mund të vijë në kundërshtim me rregullat e etikës, ai ka të drejtë t'i drejtohet njësisë së burimeve njerëzore të institucionit, e cili duhet ta këshillojë dhe ta informojë nëpunësin për sjelljen, veprimin apo mosveprimin që duhet të kryejë.

10. Për situata apo raste tepër të dyshimta dhe të patrajtuara më parë, njësia e burimeve njerëzore mund të kërkojë ndihmën e Departamentit të Administratës Publike.

11. Këshillimi mund të kërkohet dhe nga eprori për sjellje, veprime apo mosveprime të nëpunësit, nëse mendon se vijnë në kundërshtim me rregullat e etikës.

Neni 13

Manuali

1. Departamenti i Administratës Publike harton një manual, që trajton, shpjegon e komenton rregullat e etikës. Ky manual shoqërohet me raste dhe shembuj konkretë të zbatimit të rregullave të etikës.

2. Departamenti i Administratës Publike kujdeset që, në mënyrë periodike, të paktën 1 (një) herë në 3 (tre) vjet, të bëjë përditësimin e manualit të etikës.

3. Ky manual u jepet të gjithë nëpunësve të administratës publike dhe bëhet pjesë e trajnimeve, si edhe sesioneve këshilluese.

4. Njësitë e burimeve njerëzore të çdo institucioni kanë të drejtë që të bëjnë përshtatje të këtij manuali në përputhje me tematikën dhe problematikat që lidhen ekskluzivisht me këtë institucion. Kjo përshtatje bëhet nëpërmjet materialeve shtesë dhe gjithmonë nën mbikëqyrjen e Departamentit të Administratës Publike.

Neni 14

Trajnimi

1. Formimi profesional/trajnimi i nëpunësve të administratës publike për standardet e sjelljes etike ofrohet nga institucioni përgjegjës për trajnimin e nëpunësve të administratës publike.

2. Për nëpunësit civilë, standardet e sjelljes etike bëhen pjesë e:

a) programit të formimit fillestar për nëpunësit civilë;

b) programit të formimit të vazhdueshëm, sipas kërkesave të institucioneve të administratës publike, si dhe në rastet e ndryshimit/përditësimit të këtyre rregullave.

3. Për nëpunësit e administratës publike, marrëdhëniet e punësimit të të cilëve rregullohen me legjislacion të ndryshëm nga legjislacioni i shërbimit civil, trajnimi për standardet e sjelljes etike ofrohet nga institucioni përgjegjës për trajnimin e nëpunësve të administratës publike pa pagesë individuale të nëpunësit, sipas përcaktimit për këtë qëllim në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave për trajnimin e nëpunësve civilë, si dhe të çdo individi tjetër jashtë shërbimit civil.

4. Në fillim të çdo viti, Departamenti i Administratës Publike harton planin e trajnimeve dhe të nevojave përkatëse për këtë tematikë mbi bazën e kërkesave të institucioneve të administratës publike dhe njofton edhe institucionin përgjegjës për trajnimin e nëpunësve të administratës publike për këtë qëllim.

Neni 15

Mbikëqyrja

1. Mbikëqyrja e zbatimit të rregullave të etikës realizohet nga Departamenti i Administratës Publike, nga njësitë e burimeve njerëzore, si edhe nga eprorët direktë.

2. Departamenti i Administratës Publike merr informacione nga njësitë e burimeve njerëzore për çdo rast të evidentuar, si edhe realizon inspektime periodike nëpër institucione, me qëllim mbikëqyrjen e zbatimit të rregullave të etikës.

3. Njësitë e burimeve njerëzore marrin informacione në mënyrë të vazhdueshme për çështjet që kanë të bëjnë me rregullat e etikës në institucion dhe ia raportojnë rregullisht Departamentit të Administratës Publike, titullarit të



institucionit, si edhe eprorit të nëpunësit/punonjësit, për marrjen e masave përkatëse.

4. Eprori i nëpunësit, në rast se gjatë veprimtarisë së përditshme vëren shkelje apo problematika në zbatimin e rregullave të etikës, përveç masave që mund të marrë vetë, informon edhe njësinë e burimeve njerëzore.

Neni 16 Disiplina

1. Procedura disiplinore në kuadër të shkeljes së rregullave të etikës për:

a) nëpunësit civilë rregullohet sipas legjislacionit në fuqi për nëpunësin civil;

b) nëpunësit e tjerë jashtë shërbimi civil rregullohet sipas legjislacionit përkatës, që gjen zbatim për marrëdhënien e tyre të punës.

2. Masat disiplinore ndaj nëpunësve të administratës publike jepen nga organet kompetente, sipas legjislacionit respektiv.

3. Moszbatimi i parashikimeve të këtij vendimi përbën shkak për marrjen e masave ndaj nëpunësve të administratës publike.

4. Masat disiplinore për shkelje të rregullave të etikës bëhen pjesë e dosjes personale të nëpunësit të institucioneve të administratës publike dhe hidhen në Regjistrin Qendror të Personelit, të administruar nga Departamenti i Administratës Publike.

5. Njësitë e burimeve njerëzore kanë detyrimin e hedhjes së masave disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit brenda 10 (dhjetë) ditëve nga marrja e saj.

6. Masat disiplinore për nëpunësit e administratës publike shuhen pas kalimit të afateve të përcaktuara në legjislacionin e tyre respektiv.

7. Masa disiplinore e shuar fshihet nga dosja e personelit dhe hiqet menjëherë nga Regjistri Qendror i Personelit prej njësisë së burimeve njerëzore.

KREU VII DISPOZITA KALIMTARE

1. Ngarkohen të gjitha institucionet e administratës publike që, brenda gjashtëmujorit të parë të vitit 2022, të hartojnë dhe të përshtatin rregulloret e tyre të brendshme në përputhje me këtë vendim.

2. Ngarkohen institucionet e administratës publike të njoftojnë nëpunësit e tyre për rregulloret e reja dhe t'i publikojnë ato në faqet zyrtare elektronike.

3. Ngarkohen të gjithë nëpunësit e administratës publike për zbatimin e përcaktimeve të këtij vendimi.

VENDIM Nr.875, datë 29.9.2021

PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.830, DATË 15.9.2013, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E KODIT ETIK MINISTROR”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 16, 17 e 18, të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në tekstin e Kodit Etik Ministror, bashkëlidhur vendimit nr.830, datë 15.9.2013, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Pas paragrafit të parë, të nenit 2, shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

“Rregullat etike të këtij Kodi janë të detyrueshme për t'u zbatuar edhe nga zëvendësministrat.”.

2. Në pikën 2, të nenit 3, pas fjalëve “... mbështetjen e tij në publik ...” shtohen “... dhe në institucionet shtetërore ...”.

3. Në pikën 2, të nenit 5, pas fjalëve “... të shmangë në publik ...” shtohen “... dhe në institucionet shtetërore ...”.

4. Pas pikës 2, të nenit 7, shtohet pika 3, me këtë përmbajtje:

“3. Përcaktimet e pikave 1 dhe 2, të këtij neni, janë të vlefshme edhe për mbledhjet e Këshillit të Ministrave që zhvillohen *on-line*, për shkak të situatave që nuk lejojnë pjesëmarrjen në ambiente të mbyllura apo sa herë gjykohet e arsyeshme.”.

5. Pas nenit 7 shtohet neni 7/1, me këtë përmbajtje:



“Neni 7/1
Solemniteti

1. Anëtari i Këshillit të Ministrave, në mbledhjet e Këshillit të Ministrave, në paraqitjen në komisionet parlamentare, në seancë plenare dhe në veprimtaritë e tjera publike:

a) ruan solemnitetin dhe imazhin e Këshillit të Ministrave;

b) shfaq tiparet më të mira të personalitetit të tij;

c) paraqitet me veshje zyrtare në përshtatje me funksionin që kryen. Për qëllim të këtij neni, veshja duhet të përmbushë standardet e profesionalizmit dhe të modestisë, pa u bërë shkak debati dhe tërheqje vëmendjeje nga publiku;

ç) mban marrëdhënie profesionale dhe kolegjiale me shërbimet e Këshillit të Ministrave dhe personat e tjerë të angazhuar në mbledhjet e Këshillit të Ministrave.

2. Zyrat e ministrave duhet të jetë të arregduara në mënyrë modeste dhe pa u bërë shkak debati dhe tërheqje vëmendjeje nga publiku.”

6. Pas pikës 3, të nenit 10, shtohet pika 4, me këtë përmbajtje:

“4. Ministri garanton “derën e hapur”, duke u angazhuar seriozisht për çdo shqiptar të talentuar, të mirëshkolluar, me prirje të veçanta, me eksperiencë pune brenda dhe jashtë vendit, që kërkon të bëhet pjesë e administratës shtetërore.”

7. Pas shkronjës “d”, të nenit 11, shtohet shkronja “dh”, me këtë përmbajtje:

“dh) të jetë model për personelin dhe të sillet në mënyrë që të nxisë zbatimin e standardeve më të larta të sjelljes edhe për të rinjtë që kontribuojnë në administratën publike.”

8. Pas shkronjës “gj”, të nenit 12, shtohen shkronjat “h”, “i”, “j”, “k”, “l” dhe “ll”, me këtë përmbajtje:

“h) të udhëtojnë në *first class* apo *business class* në Evropë ai dhe personeli që e shoqëron në udhëtime të ndryshme;

i) të pranojë bileta udhëtimi të paguara nga një person/kompani private për veten apo për familjarët e vet;

j) të përdorë sallën *VIP* të aeroportit për familjarët e vet, në rast se nuk udhëton ai vetë;

k) të përdorë automjetin zyrtar për familjarët e vet dhe nga familjarët e vet, kur nuk është vetë i pranishëm në automjet;

l) të frekuentojë ambiente, në të cilat zhvillohen aktivitete të lojërave të fatit;

ll) të organizojë evente (festa) me personelin apo persona të tjerë, me fonde të buxhetit të shtetit.”

9. Pas nenit 12 shtohet neni 12/1, me këtë përmbajtje:

“Neni 12/1

Leja e pagueshme vjetore dhe frekuentimi i ambienteve publike

1. Anëtarët e Këshillit të Ministrave kryejnë lejen e zakonshme vjetore në territorin e Republikës së Shqipërisë, në periudha të përcaktuara nga Kabineti i Kryeministrit.

2. Anëtarët e Këshillit të Ministrave, vetëm gjatë ditëve të pushimit dhe festave zyrtare, në raste të eventeve familjare apo shoqërore, mund të frekuentojnë ambiente të ndryshme shërbimi, bar/restorant, nëse kjo nuk cenon figurën e tij etike dhe të kabinetit qeveritar, apo në raste të veçanta për arsye pune, të bëra me dije më parë.”

10. Pas nenit 13 shtohet neni 13/1, me këtë përmbajtje:

“Neni 13/1

Nënshkrimi i akteve zyrtare

Ministri në detyrë nënshkruan aktet zyrtare deri në momentin e betimit të ministrit të ri.”

11. Në pikën 1, të nenit 15, fjalët “... për sa është e mundur, të merret pëlqimi i Zyrës së Komunikimit, pranë Këshillit të Ministrave ...” zëvendësohen me “... të koordinohet me agjencinë përgjegjëse për median dhe informimin ...”.

12. Pas paragrafit të parë, të nenit 16, shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

“Anëtari i Këshillit të Ministrave ndalohej të publikojë apo të komentojë në rrjetet sociale të dhëna, lajme apo informacione sensitive apo konfidenciale, për të cilat është në dijeni për shkak të detyrës. Kjo ndalesë aplikohet edhe në faqe interneti të lexueshme nga shumë persona.”

13. Pas pikës 3, të nenit 25, shtohet pika 4, me këtë përmbajtje:

“4. Ministri përgjegjës për standardet, pas konsultimit me ILDKPKI-në, mundëson përmbledhjen e rregullave të etikës për ministrat në një manual të vetëm, me udhëzime konkrete për zbatimin e detyrimeve që burojnë nga legjislacioni



për konfliktin e interesit e ky Kod, si dhe siguron ndërgjegjësime periodik, së paku një herë në 3 muaj, për anëtarët e Këshillit të Ministrave mbi këtë legjislacion dhe legjislacionin përkatës për integritetin në ushtrimin e funksioneve publike.”.

14. Në nenin 26 bëhen këto shtesa:

a) Pas shkronjës “d” shtohet shkronja “dh”, me këtë përmbajtje:

“dh) të zhvillojë takime me përfaqësues të biznesit apo grupeve të interesit pa praninë e dy nëpunësve/funksionarëve të lartë të ministrisë përkatëse dhe pa mbajtur minutat e takimeve, regjistrimin e identitetit të personave të përfshirë në këto takime, si dhe evidentimin e çështjeve të diskutuara në një regjistër të posaçëm që mbahet nga sekretari i përgjithshëm i ministrisë përkatëse”.

b) Në fund të nenit shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

“Anëtarët e Këshillit të Ministrave mund të konsultohen me Komisionin e Etikës për përfshirjen e tyre në veprimtari me palë të treta.”.

15. Në nenin 29 bëhen këto shtesa:

a) Në paragrafin e fundit, të pikës 4, pas fjalës “... paraprakisht ...” shtohet “... konfidencialisht ...”.

b) Në fund të pikës 5 shtohet fjalia, me këtë përmbajtje:

“Dhuratat, që i bëhen anëtarit të Këshillit të Ministrave apo delegacioneve që e shoqërojnë atë, duhet të inventarizohen dhe mund të bëhen pjesë e dekorit të zyrave të ministrave, të dorëzohen në ambientet përkatëse të Kryemistrit, të caktuara për këtë qëllim, apo të vendosen në godinën e ministrisë kur një ambient i tillë është i mundur.”.

c) Pas pikës 5 shtohen pikat 6 dhe 7, me këtë përmbajtje:

“6. Anëtarit i Këshillit të Ministrave nuk mund t’i bëjë dhurata personelit që ka në varësi, me përjashtim të atyre simbolike.

7. Ministri përgjegjës për standardet, pas konsultimit me ILDKPKI-në, harton një manual shpjegues për zbatimin e detyrimeve mbi dhuratat, favoret dhe trajtimet preferenciale të parashikuara në këtë Kod.”.

16. Pas pikës 2, të nenit 31, shtohet pika 3, me këtë përmbajtje:

“3. Për çdo udhëtim pune jashtë shtetit njoftohen ministria përgjegjëse për punët e jashtme dhe Kabineti i Kryeministrit. Shpenzimet për shërbimet jashtë shtetit paguhen pasi të jetë dërguar

raporti përkatës në ministrinë përgjegjëse për punët e jashtme.”.

17. Pas pikës 2, të nenit 35, shtohet pika 3, me këtë përmbajtje:

“3. Ministrat zbatojnë me përpikëri rregullat e qarkullimit rrugor.”.

18. Pas shkronjës “a”, të pikës 2, të nenit 40, shtohet shkronja “a/1”, me këtë përmbajtje:

“a/1) kërkimi i ndjesës publike ose lënia e detyrës, në varësi të shkeljes;”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr.252, datë 29.4.2022

**PËR PROCEDURAT E OFRIMIT TË
SHËRBIMEVE ON-LINE NGA
INSTITUCIONET SHËRBIMOFRUESE
DHE PËR METODOLOGJINË E
MONITORIMIT E TË KONTROLLIT TË
VEPRIMTARISË ADMINISTRATIVE TË
OFRIMIT TË TYRE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr.107/2021, “Për bashkëqeverisjen”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Në fushën e veprimit të këtij vendimi përfshihen shërbimet e të gjitha institucioneve shërbimofruese, aplikimet e të cilave kryhen nëpërmjet platformës “e-Albania” dhe që duhet të realizohen vetëm elektronikisht, duke siguruar lëshimin e dokumentit përfundimtar me vulë elektronike ose nënshkrim elektronik.

2. Ky vendim ka për qëllim të sigurojë që ofrimi në mënyrë elektronike i shërbimeve të institucioneve shtetërore të jetë sa më cilësor dhe në përputhje me përcaktimet e nenit 61, të ligjit nr.107/2021, “Për bashkëqeverisjen”, dhe të legjislacionit në fuqi.

3. Ky vendim ka për objekt rregullimin e:



a) procedurës së ofrimit të shërbimit në mënyrë elektronike nga institucionet shtetërore, duke lëshuar dokumentin përfundimtar elektronik, me nënshkrim ose vulë elektronike, në favor të subjektit kërkuar;

b) procedurës dhe të afateve të shkëmbimit të dokumenteve ndërmjet institucioneve, nëpërmjet sistemit të qarkullimit të dokumenteve me nënshkrim elektronik, në rastet kur duhet të ketë shkëmbim dokumentacioni shoqërues ndërmjet institucioneve deri në marrjen e shërbimit dhe të dokumentit elektronik me vulë elektronike ose nënshkrim elektronik;

c) metodologjisë së monitorimit dhe të kontrollit të veprimtarisë administrative, që kryhet në funksion të ofrimit të shërbimit në mënyrë elektronike.

4. Ndërveprimi i institucioneve ofruese të shërbimit me subjektet kërkuar, si dhe vendosja në dispozicion të tyre e dokumentit elektronik kryhen nëpërmjet platformës “*e-Albania*”. Të gjitha institucionet, që ofrojnë shërbime publike të lëshimit të dokumenteve zyrtare, janë të detyruara t’ia vendosin ato në dispozicion subjekteve kërkuar, në formën e dokumentit elektronik, me nënshkrim ose vulë elektronike, nëpërmjet platformës së sipërpërmendur.

5. Në këtë vendim, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) **“Institucion shtetëror”**, institucioni i administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave, sipas kuptimit të ligjit nr.90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”;

b) **“Shërbim on-line”**, procesi që konsiston në apo konkludohet me vendosjen në dispozicion të informacionit, lëshimin e një akti administrativ apo dokumenti zyrtar, në favor të subjektit kërkuar apo përfitues, në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative dhe që në kuadër të këtij vendimi kryhet vetëm elektronikisht, sipas nenit 61, të ligjit nr.107/2021, “Për bashkëqeverisjen”;

c) **“Platforma “*e-Albania*””** ose **“Portali unik qeveritar “*e-Albania*””**, ka të njëjtin kuptim si në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore “Portali unik qeveritar “*e-Albania*”” dhe miratimin e rregullave për mënyrën e funksionimit të pikës së vetme të kontaktit;

ç) **“Sistemi i qarkullimit të dokumenteve me nënshkrim elektronik”**, në vijim i quajtur “SQDNE”, është sistemi i cili bën të mundur komunikimin, shkëmbimin e dokumenteve shoqëruese të kërkuara ndërmjet institucioneve për ofrimin e shërbimit, aplikimi i të cilit realizohet nëpërmjet platformës “*e-Albania*”, deri në lëvrimin e tij dhe lëshimin e dokumentit përfundimtar me vulë elektronike ose nënshkrim elektronik, si dhe monitorimin e lëvrimit të shërbimit sipas afateve ligjore.

II. PROCEDURAT E OFRIMIT TË SHËRBIMIT NË MËNYRË ELEKTRONIKE DHE TË SHKËMBIMIT TË DOKUMENTEVE NDËRMJET INSTITUCIONEVE

A) Ofrimi i shërbimit në mënyrë elektronike, pa shkëmbim dokumentacioni me institucione të tjera

6. Institucioni shtetëror është i detyruar të administrojë kërkesat për shërbim nëpërmjet platformës “*e-Albania*”.

7. Në rast se pranë institucionit paraqiten kërkesa për shërbim në rrugë postare në formën e dokumentit shkresor apo nëpërmjet postës elektronike, atëherë ai nuk e realizon atë, por i kthen përgjigje kërkuar, brenda 10 (dhjetë) ditëve kalendarike, duke e udhëzuar ta paraqesë kërkesën nëpërmjet platformës “*e-Albania*”.

Përfundimisht, vetëm dokumentet shoqëruese të kërkesës, të cilat nuk mund të ngarkohen në format elektronik, i dërgohen institucionit në format shkresor (hard copy). Në këto raste, kërkuar paraqet kërkesën për shërbim nëpërmjet platformës “*e-Albania*”, ndërsa dokumentacionin shoqërues të saj, origjinal apo të njëzuar me të, e dorëzon në rrugë postare pranë institucionit përkatës.

8. Afati i institucionit shtetëror për realizimin e shërbimit, në kuptim të neneve 56 dhe 57 të Kodit të Procedurave Administrative, llogaritet dhe fillon të ecë pas ditës kur kërkuar ka paraqitur kërkesën në platformën “*e-Albania*”.

9. Afati i zbatueshëm për realizimin e shërbimit nga institucioni shtetëror është ai i përcaktuar në legjislacionin e posaçëm që rregullon veprimtarinë e tij dhe procedurën administrative konkrete.

10. Në mungesë të një afati të shprehur në legjislacionin e posaçëm, atëherë zbatohen, sipas



rastit, afatet e mëposhtme për realizimin e shërbimeve *on-line*.

a) 10 (dhjetë) ditë pune nga paraqitja e kërkesës, në përputhje me pikën 1, të nenit 15, të ligjit nr.119/2014, “Për të drejtën e informimit”, kur shërbimi ka të bëjë vetëm me vendosjen në dispozicion të informacionit apo lëshimin e një dokumenti që realizohet apo hartohet pa nevojën e hetimit administrativ;

b) 10 (dhjetë) ditë kalendarike nga paraqitja e kërkesës, në përputhje me pikën 5, të nenit 49, të Kodit të Procedurave Administrative, kur shërbimi ka të bëjë me njësimin e dokumenteve;

c) 60 (gjashtëdhjetë) ditë kalendarike nga paraqitja e kërkesës, në përputhje me pikën 2, të nenit 91, të Kodit të Procedurave Administrative, kur shërbimi kërkon kryerjen e hetimit administrativ ose në rastet kur për kryerjen e shërbimit nevojiten procedura vendimmarrjeje dhe miratimi nga komisione të posaçme.

11. Shërbimi i vendoset në dispozicion kërkuarit, brenda afatit përkatës, në formën e dokumentit elektronik me nënshkrim ose vulë elektronike, duke ia përcjellë nëpërmjet platformës “*e-Albania*”, në sesionin “hapësira ime”.

B) Ofrimi i shërbimit në mënyrë elektronike, kur nevojitet shkëmbimi i dokumentacionit me institucione të tjera

12. Nëpunësi i administratës është i detyruar që kërkesën për ndihmë administrative për kryerjen e një ose disa veprimeve të nevojshme, veçanërisht për njohjen me dokumente, fakte apo mjete të tjera të provës, në administrim të organit tjetër, sipas përcaktimit të nenit 71, të Kodit të Procedurës Administrative, ta dërgojë jo më vonë se 1 (një) ditë pune nga paraqitja e kërkesës nga kërkuari. Në çdo rast, ndihma administrative, sipas kësaj pike, kërkohet nëpërmjet SQDNE-së.

13. Detyrimi i nëpunësit të administratës shtetërore, për mundësimin e dokumenteve në SQDNE nis në momentin e marrjes së kërkesës për dokumentacionin shoqërues nëpërmjet SQDNE-së.

14. SQDNE-ja mundëson komunikimin për shkëmbimin e dokumenteve shoqëruese të kërkuara ndërmjet institucioneve për ofrimin e shërbimit, aplikimi i të cilit realizohet nëpërmjet platformës “*e-Albania*”, deri në lëshimin e dokumentit përfundimtar me vulë elektronike ose

nënshkrim elektronik, si dhe monitorimin e ofrimit të shërbimit, sipas afateve ligjore.

15. Shkëmbimi i dokumenteve dhe komunikimi ndërmjet institucioneve kryhen vetëm nëpërmjet SQDNE-së, në të cilin kanë akses punonjësit e administratës shtetërore, të caktuar për ndjekjen e procesit.

16. Në rastet kur nëpunësi i caktuar, për shkak pamundësie apo të kryerjes së pushimeve vjetore të pagueshme apo pushimeve të tjera me ose pa pagesë, nuk është prezent në punë, institucioni duhet të marrë masa për personin zëvendësues, i cili akseson sistemin me kredencialet e tij, me qëllim respektimin e afateve të shërbimit.

17. Aksesimi në sistem i punonjësit të administratës bëhet nëpërmjet kredencialeve personale, duke bërë të mundur identifikimin e tij në sistemin SQDNE, sipas legjislacionit që rregullon identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara.

18. Dokumentet e hedhura në SQDNE nga punonjësi i administratës duhet të jenë të ngarkuara në këtë sistem sipas formatit të zyrtarizuar, të jenë të nënshkruara elektronikisht ose të pajisura me vulë elektronike, në varësi të dokumentit. Dokumentet, të cilat janë të ngarkuara në SQDNE dhe rezultojnë si të përfunduara, kanë vlerë të njëjtë me dokumentet e lëshuara në formën e shkresës fizike nga institucioni.

19. Të gjitha institucionet, që marrin kërkesën për dokumentacion shoqërues nga institucionet kërkuuese, kanë detyrimin t’u vendosin atyre në dispozicion në SQDNE dokumentet shoqëruese të kërkuara, brenda afatit të përcaktuar në ligjin përkatës ose, në mungesë të tij, brenda 2 (dy) ditëve pune nga e nesërmja e marrjes së kërkesës për dokumentet shoqëruese në sistem.

20. Bëjnë përjashtim nga pika 19, e këtij vendimi, rastet kur shërbimi i kërkuar nga kërkuari duhet t’i mundësohet atij brenda 1 (një) dite pune. Në varësi të këtyre shërbimeve, shkëmbimi i dokumenteve ndërmjet institucioneve, nëpërmjet SQDNE-së duhet të kryhet brenda 1 (një) dite pune nga e nesërmja e marrjes së kërkesës për dokumentet shoqëruese në sistem.

21. Në rastet kur dokumentacioni shoqërues, i cili mundësohet apo gjenerohet nga institucionet, ka detyrim financiar, kërkesa konsiderohet e vlefshme vetëm pas pagesës së kryer *on-line* ose pas hedhjes në sistem të mandatpagesës së kryer. Në



këto raste, afati i shkëmbimit të dokumenteve shoqëruese në sistem nis nga e nesërmeja e momentit kur vlerësohet se detyrimi financiar është përcjellë në sistem.

22. Për ndërveprimin e institucionit shtetëror me kërkuesin dhe për realizimin përfundimtar të shërbimit në favor të kërkuesit, zbatohen të njëjtat rregulla si në pikat 6 deri në 11 të këtij vendimi, duke vendosur në dispozicion të tij dokumentin përfundimtar me vulë elektronike ose nënshkrim elektronik, nëpërmjet platformës “e-Albania”.

III. MONITORIMI DHE KONTROLLI I ZBATIMIT, SHKELJET DHE PASOJAT

23. Në mënyrë që të zbatohen afatet për shërbimin ndaj kërkuesit, nëpunësit, eprori apo titullari duhet të kenë mundësinë e monitorimit nëpërmjet sistemit për të verifikuar statusin e kërkesës. Çdo nëpunës përgjegjës duhet të vetëdeklarojë, nëpërmjet sistemit, ofrimin e shërbimit ose statusin e kërkesës, duke përfshirë dhe datën në të cilën është ofruar ky shërbim te qytetari ose subjekti që ka paraqitur kërkesën.

24. Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje është institucioni përgjegjës për monitorimin e raportimin e zbatimit të afateve dhe përdorimit të SQDNE-së, në rastet kur duhet të ketë shkëmbim dokumentacioni shoqërues ndërmjet institucioneve deri në ofrimin e shërbimit dhe të dokumentit përfundimtar me vulë elektronike ose nënshkrim elektronik në platformën “e-Albania”, sipas afateve ligjore.

25. Nëpunësit përgjegjës raportojnë pranë Agjencisë për Dialog dhe Bashkëqeverisje për vonesat, kërkesat e refuzuara apo gabimet gjatë procesit për kërkim dokumentacioni, ofrimin e shërbimit dhe masat e marra nga institucioni në rast vonese në ofrimin e shërbimit.

26. Moskthimi brenda afatit të përcaktuar në këtë vendim i një dokumenti shoqërues nga institucioni përgjegjës nuk përbën pengesë për institucionin kërkues që të vijojë procedurat e mëtejshme të trajtimit të kërkesës.

27. Mosrespektimi i detyrimeve të përcaktuara në këtë vendim përbën kundërvajtje administrative dhe trajtohet sipas përcaktimeve të nenit 56, të ligjit nr.107/2021, “Për bashkëqeverisjen”, duke nisur procedurën e inspektimit. Në përfundim të inspektimit, në rast se konstatohen shkeljet e afateve dhe të procedurave të përcaktuara në këtë vendim, ndaj punonjësit apo nëpunësit përgjegjës

të administratës dhe/ose titullarit të institucionit merren masat e parashikuara në dispozitën e sipërpërmendur të ligjit nr.107/2021.

IV. DISPOZITA TË FUNDIT

28. Institucionet shtetërore, që ofrojnë shërbime publike, për të cilat nuk aplikohet ende vetëm në platformën “e-Albania”, janë të detyruara të dorëzojnë pranë AKSHI-t informacion lidhur me këto shërbime (emërtimi, formulari i aplikimit, dokumentacioni shoqërues dhe përshkrimi), brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, në mënyrë që AKSHI të marrë masa për realizimin e zhvillimeve teknike për përfshirjen e tyre në platformë, në përputhje me parashikimet e pikës 1, të nenit 61, të ligjit nr.107/2021, “Për bashkëqeverisjen”.

29. Subjekti kërkues mund të ushtrojë secilin nga këto mjete ligjore, më vete apo njëkohësisht, për të kundërshtuar mosveprimin e institucionit shtetëror ose përmbajtjen e dokumentit të lëshuar prej tij:

a) ankimin administrativ, në përputhje me rregullat, formën dhe afatet e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative dhe në legjislacionin e posaçëm që rregullon veprimtarinë e institucionit;

b) ankesën pranë Agjencisë për Dialog dhe Bashkëqeverisje, sipas ligjit nr.107/2021, “Për bashkëqeverisjen”.

30. Ngarkohen institucionet shtetërore për të miratuar, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, rregullore me karakter të brendshëm për mënyrën e zbatimit nga ana e punonjësve dhe strukturave të tyre përgjegjëse të detyrimeve që burojnë nga ky vendim.

31. Vendim nr.43, datë 15.1.2020, i Këshillit të Ministrave, “Për funksionimin e procesit të shkëmbimit të dokumenteve ndërmjet institucioneve, nëpërmjet sistemit të qarkullimit të dokumenteve me nënshkrim elektronik”, i ndryshuar, shfuqizohet.

32. Ngarkohen të gjitha institucionet shtetërore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj



VENDIM
Nr. 256, datë 29.4.2022

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.584, DATË 8.10.2021, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR SHPALLJEN E GJENDJES SË EMERGJENCËS NË FURNIZIMIN ME ENERGJI ELEKTRIKE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “ç”, të pikës 1, të nenit 90, të ligjit nr.43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave dhe të ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.584, datë 8.10.2021, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

1. Pika 3 shfuqizohet.

2. Pika 5 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“5. Gjendja e emergjencës në furnizimin me energji elektrike i shtrin efektet deri më 31 dhjetor 2022.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj

VENDIM
Nr. 257, datë 29.4.2022

PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.1299, DATË 16.12.2009, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS, TË ORGANIKËS DHE TË NUMRIT TË NËPUNËSVE TË SHËRBIMIT TË GJENDJES CIVILE NË BASHKI/NJËSI ADMINISTRATIVE DHE NË ZYRAT E ARKIVIT TË GJENDJES CIVILE PRANË PREFEKTIT TË QARKUT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 62, të ligjit nr.10129, datë 11.5.2009, “Për

gjendjen civile”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr.1299, datë 16.12.2009, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Pikat 1 dhe 4 ndryshohen, si më poshtë vijon:

“1. Struktura e shërbimit shtetëror të gjendjes civile është sipas pasqyrës nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.”.

“4. Shërbimi publik i gjendjes civile ofrohet në 394 zyra të gjendjes civile, 150 prej të cilave funksionojnë si sportele fizike, ndërsa pjesa tjetër si sportele *on-line*.”.

2. Pas pikës 4/1 shtohen pikat 4/2, 4/3 dhe 4/4, me këtë përmbajtje:

“4/2. Shërbimi i gjendjes civile ofrohet nga 524 nëpunës, gjithsej, të cilët në mënyrë alternative ofrojnë këtë shërbim.

4/3. Organizimi i sporteleve fizike në nivel qarku/bashkie bëhet sipas pasqyrës nr.3, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

4/4. Kryetarët e bashkive, bazuar në nevojat dinamike të komunitetit, përcaktojnë zyrat e gjendjes civile që funksionojnë si sportele fizike çdo vit brenda datës 5 janar. Përjashtimisht për vitin 2022, ky përcaktim bëhet brenda datës 1 maj 2022.”.

II. Ngarkohen Ministria e Brendshme, prefektët e qarqeve dhe kryetarët e bashkive për zbatimin e këtij vendimi.


Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj



Pasqyra nr. 1

Struktura e Shërbimit Shtetëror të Gjendjes Civile



Pasqyra nr.3

Sportelet e ofrimit të shërbimit të gjendjes civile				
Qarku	Bashkia	Sportel fizik Bashki	Sportel fizik Prefekturë	Sportelet fizike Total
Berat	Bashkia Berat	3	1	4
	Bashkia Dimal	1		1
	Bashkia Kuçovë	1		1
	Bashkia Poliçan	1		1
	Bashkia Skrapar	1		1
	Total Sportele	7	1	8
Dibër	Bashkia Bulqizë	1		1
	Bashkia Dibër	2	1	3
	Bashkia Klos	1		1
	Bashkia Mat	1		1
	Total Sportele	5	1	6
Durrës	Bashkia Durrës	10	1	11
	Bashkia Krujë	2		2
	Bashkia Shijak	2		2
	Total Sportele	14	1	15



Elbasan	Bashkia Belsh	1		1
	Bashkia Cërrik	2		2
	Bashkia Elbasan	6	1	7
	Bashkia Gramsh	1		1
	Bashkia Librazhd	1		1
	Bashkia Peqin	1		1
	Bashkia Prrenjas	1		1
	Total Sportele	13	1	14
Fier	Bashkia Divjakë	2		2
	Bashkia Fier	8	1	9
	Bashkia Lushnje	4		4
	Bashkia Mallakastër	1		1
	Bashkia Patos	1		1
	Bashkia Roskovec	1		1
	Total Sportele	17	1	18
Gjirokastrë	Bashkia Dropull	1		1
	Bashkia Gjirokastrë	2	1	3
	Bashkia Këlcyrë	1		1
	Bashkia Libohovë	1		1
	Bashkia Memaliaj	1		1
	Bashkia Përmet	1		1
	Bashkia Tepelenë	1		1
	Total Sportele	8	1	9
Korçë	Bashkia Devoll	1		1
	Bashkia Kolonjë	1		1
	Bashkia Korçë	3	1	4
	Bashkia Maliq	2		2
	Bashkia Pogradec	3		3
	Bashkia Pustec	1		1
	Total Sportele	11	1	12
Kukes	Bashkia Has	1		1
	Bashkia Kukës	2	1	3
	Bashkia Tropojë	1		1
	Total Sportele	4	1	5
Lezhë	Bashkia Kurbin	2		2
	Bashkia Lezhë	3	1	4
	Bashkia Mirditë	1		1
	Total Sportele	6	1	7
Shkodër	Bashkia Fushë-Arrëz	1		1
	Bashkia Malësi e Madhe	2		2
	Bashkia Pukë	1		1
	Bashkia Shkodër	6	1	7



	Bashkia Vau-Dejës	2		2
	Total Sportele	12	1	13
Tiranë	Bashkia Kamëz	2		2
	Bashkia Kavajë	3		3
	Bashkia Rrogozhinë	1		1
	Bashkia Tiranë	20	2	22
	Bashkia Vorë	1		1
	Total Sportele	27	2	29
Vlorë	Bashkia Delvinë	1		1
	Bashkia Finiq	1		1
	Bashkia Himarë	1		1
	Bashkia Konispol	1		1
	Bashkia Sarandë	2		2
	Bashkia Selenicë	1		1
	Bashkia Vlorë	6	1	7
	Total Sportele	13	1	14
TOTAL SPORTELE NE RSH		137	13	150

VENDIM**Nr. 258, datë 29.4.2022**

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.1243, DATË 11.12.2009, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E DOKUMENTEVE, QË DUHET TË PARAQESIN SHTETASIT E TË PROCEDURAVE, QË DUHET TË KRYEJNË ZYRAT E GJENDJES CIVILE NË BASHKI/NJËSI BASHKIAKE/KOMUNA DHE INSTITUCIONET SHTETËRORE, TË POSAÇME, PËR NDRYSHIMIN E VENDBANIMIT/ADRESËS SË SHTETASVE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 18, pika 4, 20, pika 4, e 22, pika 2, të ligjit nr.10 129, datë 11.5.2009, “Për gjendjen civile”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr.1243, datë 11.12.2009, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

1. Në titullin e vendimit, fjalët “... njësi bashkiake/komuna ...” zëvendësohen me “... njësi administrative ...”.

2. Kreu I, “Parime të përgjithshme”, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Shtetasit me banim në territorin e Republikës së Shqipërisë kryejnë regjistrimin ose ndryshimin e vendbanimit të tyre në rrugë elektronike (*on-line*), nëpërmjet paraqitjes së kërkesës në portalin qeveritar “*e-Albania*”, duke depozituar dokumentin e pronësisë së banesës, kontratën e qiramarrjes, huadhënies, përdorimit ose çdo dokument tjetër të ligjshëm që provon vendbanimin.

Dokumentet e ngarkuara në portalin qeveritar “*e-Albania*” nga shtetasi, që provojnë regjistrimin ose ndryshimin e vendbanimit të ri, ruhen në arkivin elektronik të Regjistrat Kombëtar të Gjendjes Civile.

2. Anëtar i madhor i familjes, i cili kërkon të regjistrojë ose të ndryshojë vendbanimin, më parë duhet të kryejë procedurën e veçimit, si familje më vete në rrugë elektronike (*on-line*), përmes paraqitjes së kërkesës nëpërmjet portalit qeveritar “*e-Albania*”, përveç rasteve të përcaktuara në pikën 4, të këtij vendimi.

3. Shtetasi, i cili kërkon të bashkohet në një familje, paraqet kërkesën në rrugë elektronike (*on-line*) nëpërmjet portalit qeveritar “*e-Albania*”, duke depozituar në portal konfirmimin e të gjithë anëtarëve madhorë të familjes pritëse, duke pasur



në konsideratë standardet e banimit, të miratuara nga legjislacioni në fuqi.”.

3. Në kreun II, “Veprimet që kryhen nga institucionet shtetërore, dokumentacioni i nevojshëm dhe afatet e komunikimit”, pikat 5 dhe 8 ndryshohen, si më poshtë vijon:

“5. Lista emërore e hartuar nga institucionet e parashikuara në pikën 4, të këtij vendimi, duhet të përmbajë emrin, mbiemrin dhe numrin personal. Kjo listë i dërgohet zyrës së gjendjes civile përkatëse nëpërmjet sistemit të qarkullimit të dokumenteve me nënshkrim elektronik.

8. Për regjistrimin e vendbanimit të ri të shtetasve, të përcaktuar në pikën 7, të këtij vendimi, institucionet shtetërore komunikojnë nëpërmjet sistemit të qarkullimit të dokumenteve me nënshkrim elektronik për shkëmbimin e dokumenteve të mëposhtme:

a) Listës emërore, ku shënohen emri, mbiemri dhe numri personal;

b) Dokumentit që vërteton vendbanimin për rastet e shtetasve që banojnë jashtë ndërtesave të institucionit.”.

4. Në kreun III, “Veprimet e zyrave të gjendjes civile”, pikat 10 dhe 11 ndryshohen, si më poshtë vijon:

“10. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, për regjistrimin e vendbanimit të shtetasve të huaj e të personave pa shtetësi, me banim të përkohshëm apo të përhershëm, në Republikën e Shqipërisë, pasi merr njoftimin dhe aktet përkatëse nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit apo zyra, që mbulon shtetësinë dhe refugjatët, i kërkon në rrugë elektronike zyrës së gjendjes civile, ku këta shtetas kanë të përcaktuar vendbanimin e tyre, të bëjë regjistrimin, sipas afateve të përcaktuara në lejen e qëndrimit, brenda 5 ditëve nga data e marrjes së njoftimit.

11. Nëpunësi i zyrës së gjendjes civile, pas marrjes së dokumentacionit e të kërkesës nga shtetasit dhe nga institucionet që e kanë këtë detyrim ligjor, bën ndryshimin e adresës së shtetasit në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile, sipas rregullave dhe procedurave të përcaktuara me urdhër të ministrit, që mbulon gjendjen civile.”.

II. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Agjencia

Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj

VENDIM
Nr. 259, datë 29.4.2022

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN
NR.928, DATË 29.12.2014, TË KËSHILLIT
TË MINISTRATVE, “PËR KRITERET,
PROCEDURAT DHE
DOKUMENTACIONIN PËR
PENSIONIN SOCIAL”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5/1, të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shkronja “a”, e pikës 2, të vendimit nr.928, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“a) Shtetasi, që plotëson kriteret për trajtimin financiar me pension social, plotëson kërkesën nëpërmjet portalit qeveritar “e-Albania”, ndërsa dokumentet origjinale dërgohen nëpërmjet shërbimit postar pranë Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore, ku kanë vendbanimin.”.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj



VENDIM

Nr. 260, datë 29.4.2022

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË
GRANTIT DHE PROJEKTIT TË BE-së,
NDËRMJET REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË (MARRËSI), TË
PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E
FINANCIVE DHE EKONOMISË,
DHE KfW FRANKFURT AM MAIN (KfW)
DHE KORPORATËS
ELEKTROENERGJETIKE SHQIPTARE
(KESH) (AGJENCIA E ZBATIMIT TË
PROJEKTIT), REHABILITIMI I
HIDROCENTRALIT TË FIERZËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes së grantit dhe projektit të BE-së ndërmjet Republikës së Shqipërisë (marrësi), të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe *KfW Frankfurt am Main* (KfW) dhe Korporatës Elektroenergjetike Shqiptare (KESH) (agjencia e zbatimit të projektit), rehabilitimi i hidrocentralit të Fierzës, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj

**MARRËVESHJE GRANTI DHE
PROJEKTI I BE-së**

E DATËS 28 JANAR 2022,
NDËRMJET KfW FRANKFURT AM MAIN
(KfW) DHE REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
(MARRËSI), TË PËRFAQËSUAR NGA
MINISTRIA E FINANCIVE DHE
EKONOMISË, DHE
KORPORATËS ELEKTROENERGJETIKE
SHQIPTARE (KESH) (AGJENCIA E
ZBATIMIT TË PROJEKTIT) PËR
8,350,000.00 EURO
REHABILITIMI I HIDROCENTRALIT
TË FIERZËS

WB-IG05-ALB-ENE-01KfW ID e projektit:
46729

PËRMBAJTJA

Neni

Neni 1 - Shuma dhe qëllimi i grantit

Neni 2 - Kanalizimi i grantit tek Agjencia e
Zbatimit të Projekteve

Neni 3 - Disbursimi

Neni 4 - Pezullimi i disbursimit dhe shlyerja

Neni 5 - Kostot dhe tarifat publike

Neni 6 - Deklaratat kontraktuale dhe
kompetencat e përfaqësimit

Neni 7 - Projekti

Neni 8 - Publikimi dhe transferimi i
informacionit të lidhur me projektin

Neni 9 - Dispozita të ndryshme

Zotimet e përputhshmërisë për marrësin

Zotimet e përputhshmërisë për Agjencinë e
Zbatimit të Projektit

Në bazë të Kushteve të Përgjithshme të Fondit të Përbashkët Evropian për Ballkanin Perëndimor (FPEBP), të datës 7 nëntor 2006, të ndryshuar herë pas here, dhe miratimit të formularit të grantit nga Komiteti Drejtues i Kornizës së Investimit të Ballkanit Perëndimor (KIBP), të datës 30 dhjetor 2020, të ndryshuar herë pas here (bashkërisht i referuar si “Dokumentacioni KIBP”), marrësi, Agjencia e Zbatimit të Projektit dhe KfW-ja lidhin grantin e mëposhtëm dhe Marrëveshjen e Projektit (Marrëveshja).

Kjo Marrëveshje është pjesë e projektit të rehabilitimit elektro-mekanik të hidrocentralit të Fierzës (Projekti). Projekti do të financohet me anë



të kësaj marrëveshjeje granti dhe projektit të BE-së, Marrëveshjes së Huas (Marrëveshja e huas) dhe marrëveshjes së grantit për masat shoqëruese (Marrëveshja e grantit shoqërues), të gjitha të së njëjtës datë me këtë Marrëveshje.

Neni 1

Shuma dhe qëllimi i grantit

1.1 KfW-ja i ofron marrësit një grant që nuk tejkalon 8.350,000.00 euro (grantit).

Ky grant nuk është i shlyeshëm, përveç kur përcaktohet ndryshe në nenin 4.2.

1.2 Marrësi kanalizon grantin plotësisht tek Agjencia e Zbatimit të Projektit, në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 2. Agjencia e zbatimit të projektit përdor grantin ekskluzivisht për rehabilitimin elektro-mekanik të hidrocentralit të Fierzës, si dhe për shërbimet e ekspertit (shërbimet e ekspertit) për tenderimin dhe mbikëqyrjen (Projekti) Agjencia e Zbatimit të Projektit dhe KfW-ja përcaktojnë detajet e projektit dhe mallrave dhe shërbimeve që do të financohen nga granti me anë të një marrëveshjeje të veçantë (Marrëveshja e Veçantë).

1.3 Taksat dhe detyrimet e tjera publike që duhet të mbulohen nga marrësi dhe Agjencia e Zbatimit të Projektit, dhe detyrimet e importit nuk do të financohen nga granti.

Neni 2

Kanalizimi i grantit tek Agjencia e Zbatimit të Projektit

2.1 Marrësi kanalizon grantin tek Agjencia e Zbatimit të Projektit si një grant jo të shlyeshëm, të dhënë sipas një marrëveshjeje të veçantë financimi të lidhur ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Agjencisë së Zbatimit të Projektit.

2.2 Para fillimit të disbursimit nga granti, marrësi i dërgon KfW-së një përkthim të certifikuar të marrëveshjes të referuar në nenin 2.1.

2.3 Kanalizimi i grantit nuk përbën ndonjë përgjegjësi të Agjencisë së Zbatimit të Projektit ndaj KfW-së, për detyrimet e pagesës sipas kësaj Marrëveshjeje.

Neni 3

Disbursimi

3.1 KfW-ja disburson grantin në përputhje me ecurinë e projektit dhe me kërkesë të Agjencisë së Zbatimit të Projektit. Me anë të një marrëveshjeje të veçantë, Agjencia e Zbatimit të Projektit dhe KfW-ja përcaktojnë procedurën e disbursimit, në veçanti dëshmitë që vërtetojnë se fondet e disbursuara janë përdorur për qëllimin e caktuar.

3.2 Në bazë të nenit 4, KfW-ja do të jetë e detyruar të kryejë disbursime sipas kësaj marrëveshjeje vetëm nëse dhe në masën që:

a) KfW-ja ka marrë fondet korresponduese sipas dokumentacionit KIBP (WBIF);

b) KfW-ja dhe Agjencia e Zbatimit të Projektit kanë lidhur marrëveshjen e veçantë; dhe

c) kushtet e përcaktuara në nenin 2.2 janë përmbushur.

3.3 KfW-ja do të ketë të drejtën të refuzojë të kryejë disbursime pas datës 30 mars 2028.

Neni 4

Pezullimi i disbursimit dhe shlyerja

4.1 KfW-ja nuk mund të pezullojë disbursimet, përveç se në rastet kur:

a) marrësi nuk i përmbush detyrimet e tij ndaj KfW-së për pagesat kur kërkohet kryerja e tyre;

b) detyrimet në kuadrin e kësaj marrëveshjeje ose sipas marrëveshjeve të veçanta të lidhura me këtë marrëveshje, janë shkelur;

c) Agjencia e Zbatimit të Projektit nuk mund të provojë që granti është përdorur për qëllimin e caktuar;

d) përmbushja e detyrimeve të KfW-së sipas kësaj marrëveshjeje shkel ligjin në fuqi;

e) disbursimet pezullohen plotësisht ose pjesërisht bazuar në dokumentacionin KIBP;

f) KfW-ja duhet të kërkojë shlyerjen e grantit që nuk është përdorur në përputhje me dokumentacionin KIBP;

g) dokumentacioni KIBP pushon së qeni i vlefshëm, efektiv, i zbatueshëm ose përfundon;

h) marrëveshja e huas ose marrëveshja e grantit shoqërues nuk ka hyrë në fuqi, ose ka ndodhur një ngjarje që lejon KfW-në të pezullojë disbursimet në përputhje me ndonjë nga marrëveshjet e lartpërmendura; ose



i) linden rrethana të jashtëzakonshme që përjashtojnë ose rrezikojnë seriozisht zbatimin, funksionimin ose qëllimin e projektit.

4.2 Nëse ndonjë prej situatave të specifikuar në nenin 4.1 “b”, “c”, “d” ose “f”, ka ndodhur dhe nuk është eliminuar brenda një periudhe të përcaktuar nga KfW-ja, e cila, megjithatë, duhet të jetë të paktën 30 ditë, KfW-ja:

a) në rastin e përcaktuar në nenin 4.1 “b” ose “d”, mund të kërkojë shlyerjen e menjëhershme të të gjitha shumave të disbursuara;

b) në rastin e specifikuar në nenin 4.1 “c” ose “f”, mund të kërkojë shlyerje të menjëhershme të atyre shumave që Agjencia e Zbatimit të Projektit nuk mund të provojë se janë përdorur për qëllimin e caktuar.

Neni 5

Kostot dhe detyrimet publike

Marrësi mbulon të gjitha taksat dhe detyrimet e tjera publike që bëhen jashtë Republikës Federale të Gjermanisë, për lidhjen dhe zbatimin e kësaj marrëveshjeje, si dhe të gjitha kostot e transferimit dhe konvertimit që linden në lidhje me disbursimin e grantit.

Neni 6

Deklaratat kontraktuale dhe fuqia e përfaqësimit

6.1 Ministri i Financave dhe Ekonomisë i Republikës së Shqipërisë përfaqëson marrësin në zbatimin e kësaj marrëveshjeje. Drejtori ekzekutiv i Agjencisë së Zbatimit të Projektit dhe personat e caktuar prej tij ose saj për KfW-në dhe të autorizuar nga nënshkrime model të vërtetuara prej tij ose saj, do të përfaqësojnë Agjencinë e Zbatimit të Projektit në zbatimin e kësaj marrëveshjeje. Fuqia e përfaqësimit nuk do të skadojë deri në marrjen nga ana e KfW-së të revokimit të tij të shprehur nga përfaqësuesi i autorizuar në atë kohë.

6.2 Ndryshimet ose shtesat e kësaj marrëveshjeje, si dhe njoftimet dhe deklaratat e lëshuara nga palët kontraktuese, në kuadrin e kësaj marrëveshjeje, bëhen me shkrim. Ministri i Financave dhe Ekonomisë është i autorizuar të nënshkruajë çdo ndryshim që duhet miratuar nga Këshilli i Ministrave. Ndryshimet e kësaj marrëveshjeje që cenojnë vetëm periudhën e disponueshmërisë (neni 3.3) nuk kërkojnë miratim paraprak nga Këshilli i Ministrave. Çdo njoftim apo

deklaratë e tillë konsiderohet e marrë sapo të ketë arritur në adresën e mëposhtme të palës kontraktuese përkatëse ose në atë adresë tjetër të palës kontraktuese përkatëse, siç i është njoftuar palës tjetër kontraktuese:

Për KfW-në: KfW

Postfach 11 11 41

60046 Frankfurt am Main

Federal Republic of Germany (Republika Federale e Gjermanisë).

Për marrësin: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Bulevardi “Dëshmorët e Kombit” nr. 3

Tiranë, Shqipëri.

Për Agjencinë e Zbatimit të Projektit:
Korporata Elektroenergetike Shqiptare (KESH)
Blloku Vasil Shanto
1001 Tiranë, Shqipëri.

6.3 Ndryshimet e kësaj marrëveshjeje që cenojnë vetëm marrëdhëniet ligjore ndërmjet KfW-së dhe marrësit nuk kërkojnë pëlqimin e Agjencisë së Zbatimit të Projektit.

Neni 7

Projekti

7.1 Agjencia e Zbatimit të Projektit:

a) do të përgatisë, zbatojë, operojë dhe mirëmbajë projektin, në përputhje me praktikat e qëndrueshme financiare dhe inxhinierike, sipas standardeve mjedisore dhe sociale, dhe kryesisht në përputhje me konceptin e dakordësuar të projektit ndërmjet Agjencisë së Zbatimit të Projektit dhe KfW-së;

b) do t'i delegojë përgatitjen dhe mbikëqyrjen e ndërtimit të projektit inxhinierëve konsulentë të pavarur, të kualifikuar dhe zbatimin e projektit firmave të kualifikuara;

c) do të realizojë në çdo kohë dispozitat e prokurimit të përcaktuara në marrëveshjen e veçantë, duke përfshirë planin përkatës të prokurimit;

d) do të fillojë zbatimin e shërbimeve të ekspertit para datës 30.1.2022;

e) do të përfundojë zbatimin e shërbimeve të ekspertit deri në datën 30.12.2027;



f) do të mbajë ose sigurojë mbajtjen e librave dhe regjistrave që specifikojnë qartë të gjitha kostot e mallrave dhe shërbimeve të kërkuara për projektin dhe që identifikojnë qartë mallrat dhe shërbimet e financuara nga ky grant;

g) do t'u mundësojë përfaqësuesve të KfW-së, në çdo kohë, librat dhe regjistrat e lartpërmendur, si dhe çdo dokumentacion tjetër që lidhet me zbatimin dhe funksionimin e projektit dhe të vizitojnë projektin, dhe të gjitha godinat lidhur me projektin;

h) do t'i dorëzojë KfW-së, brenda dy javëve nga kërkesa, çdo dhe të gjitha informacionet dhe raportet e tilla mbi projektin dhe progresin e tij të mëtejshëm siç mund të kërkojë KfW-ja, duke përfshirë por pa u kufizuar në informacionin dhe raportet e kërkuara për përmbushjen e detyrimeve të raportimit të KIBP-it, në veçanti i. raportet vjetore të zbatimit në fund të shkurtit të çdo viti, duke përfshirë një pjesë narrative dhe financiare; si dhe ii. të dhëna përkatëse për përditësimet gjysmëvjetore në sistemin e informacionit të menaxhimit të KIBP-it deri në fund të marsit dhe shtatorit të çdo viti;

i) do të miratojë masa të arsyeshme, në përputhje me rregulloret dhe rregullat e veta, për të garantuar që kandidatët ose tenderuesit dhe aplikantët e mundshëm të përjashtohen nga pjesëmarrja në një procedurë prokurimi dhe nga dhënia e një kontrate prokurimi të financuar nga fondet e BE-së/KIBP-it, nëse marrësi vihet në dijeni se këto subjekte:

i. ose personat që kanë kompetenca përfaqësimi, vendimmarrjeje ose kontrolli mbi ta kanë qenë objekt i një vendimi të formës së prerë ose i një vendimi përfundimtar administrativ për mashtrim, korrupsion, përfshirje në një organizatë kriminale, pastrim parash, vepra të lidhura me terrorizmin, punë të fëmijëve ose trafikim të qenieve njerëzore;

ii. ose personat që kanë kompetenca përfaqësimi, vendimmarrjeje ose kontrolli mbi ta kanë qenë objekt i një gjykimi përfundimtar ose i një vendimi përfundimtar administrativ për një parregullsi që cenon interesin financiar të BE-së;

iii. janë fajtorë për keqinterpretim në sigurimin e informacionit të kërkuar si kusht të pjesëmarrjes në procedurë ose nëse nuk mund të japin këtë informacion.

7.2 Agjencia e Zbatimit të Projektit dhe KfW-ja përcaktojnë detajet lidhur me nenin 7.1 me një marrëveshje të veçantë.

7.3 Marrësi, përmes Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, dhe Agjencia e Zbatimit të Projektit:

a) do të sigurojnë financimin e plotë të projektit dhe, me kërkesë, i japin KfW-së dëshmi që tregojnë se janë mbuluar kostot e papaguara nga ky grant;

b) me porosi të tyre do të informojnë menjëherë KfW-në për çdo dhe të gjitha rrethanat që përjashtojnë ose rrezikojnë seriozisht zbatimin, funksionimin ose qëllimin e projektit;

c) do të marrin masa efektive dhe proporcionale për të zbutur rrezikun e shfaqjes së praktikave të ndaluara ose ndonjë aktiviteti tjetër të paligjshëm në lidhje me përdorimin e grantit dhe/ose zbatimin e projektit. Të gjitha rastet e praktikave të ndaluara që lidhen me grantin dhe/ose zbatimin e projektit, si dhe masat në lidhje me to, të marra nga marrësi dhe/ose Agjencia e Zbatimit të Projektit, duhet t'i raportohen menjëherë KfW-së. Marrësi, nëpërmjet Agjencisë së Zbatimit të Projektit, do të ndërmarrë veprime për të ndërprerë kontratat me kontraktuesit, në lidhje me të cilat është përcaktuar që kontraktues të tillë kanë qenë të përfshirë në praktika të tilla të ndaluara, në lidhje me zbatimin e projektit, dhe të marrë masat e duhura për të rimarrë grantin ose pjesën e tij e cila është keqpërdorur.

“Praktikat e ndaluara”: nënkupton një ose më shumë nga sa vijon:

i. praktikë shtrënguese, siç përcaktohet në shtojcën 1;

ii. praktikë e fshehtë, siç përcaktohet në shtojcën 1;

iii. praktikë korruptive, siç përcaktohet në shtojcën 1;

iv. praktikë mashtruese, siç përcaktohet në shtojcën 1; dhe

v. vjedhje që do të thotë keqpërdorim i pasurisë që i përket një pale tjetër;

d) do t'i mundësojnë Komisionit Evropian dhe Gjykatës Evropiane të Audituesve ose ndonjë përfaqësuesi të autorizuar që të kryejnë rishikime analizuese dhe kontrole në vend për përdorimin e grantit (duke përfshirë procedurat për dhënien e kontratave të financuara nga granti) mbi bazën e dokumenteve mbështetëse të kontabilitetit dhe ndonjë dokumenti tjetër të lidhur me financimin e projektit;



e) do t'i mundësojnë Zyrës Evropiane të Kundër-Mashtimit (në vijim e referuar si "OLAF") të kryejë hetimet, duke përfshirë kontrollet në vend, në përputhje me dispozitat e përcaktuara nga ligji i BE-së për mbrojtjen e interesave financiarë të BE-së nga mashtrimi, korrupsioni dhe çdo aktivitet tjetër i paligjshëm dhe, kur është e zbatueshme, çdo marrëveshje bashkëpunimi administrative kundër mashtimit, e lidhur midis OLAF-it dhe organeve të KfW-së;

f) do t'i ofrojnë zyrtarëve të Komisionit Evropian, OLAF-it dhe Gjykatës Evropiane të Audituesve dhe agjentëve të tyre të autorizuar, sipas kërkesës, informacion dhe akses në çdo dokument dhe të dhëna të kompjuterizuara, në lidhje me menaxhimin teknik dhe financiar të operacioneve të financuara në bazë të kësaj marrëveshjeje, si dhe t'u japë atyre akses në vende dhe mjedise në të cilat kryhen operacione të tilla. Dokumentet dhe të dhënat e kompjuterizuara mund të përfshijnë informacione që Agjencia e Zbatimit të Projektit i konsideron konfidenciale, siç rregullohen nga marrëveshja kontraktuale. Një informacion i tillë, pasi i jepet Komisionit Evropian, OLAF-it, Gjykatës Evropiane të Audituesve, ose ndonjë përfaqësuesi tjetër të autorizuar, do të trajtohet në përputhje me rregullat dhe legjislacionin e konfidencialitetit të BE-së. Dokumentet duhet të jenë të aksesueshme dhe të paraqiten në atë mënyrë që lejojnë kryerjen e kontrolleve, ndërsa marrësi është i detyruar ligjërisht të informojë Komisionin Evropian, OLAF-in ose Gjykatën Evropiane të Audituesve për vendndodhjen e saktë ku mbahen. Kur është e nevojshme, palët mund të bien dakord të dërgojnë kopje të këtyre dokumenteve për rishikime analitike;

g) do të informojnë Komisionin Evropian nëse në lidhje me zbatimin e projektit, ndonjë prej tyre ka konstatuar se një palë e tretë është përfshirë në një nga situatat e përmendura më poshtë ose nëse ka zbuluar një mashtrim dhe/ose parregullsi. Komisioni Evropian do ta paraqesë këtë informacion në Sistemin e Zbulimit të Hershëm dhe Përrjashtimit. Marrësi dhe Agjencia e Zbatimit të Projektit do të informojnë Komisionin Evropian kur ndonjë prej tyre vihet në dijeni se informacioni i transmetuar duhet të korrigjohet, përditësohet ose hiqet. Marrësi dhe Agjencia e Zbatimit të Projektit do të sigurojnë që subjekti në fjalë të informohet se të dhënat e saj janë transmetuar në Komisionin

Evropian dhe mund të përfshihen në Sistemin e Zbulimit të Hershëm dhe Përrjashtimit dhe të publikohen në faqen e internetit të Komisionit Evropian;

h) do të sigurojnë zbatimin e udhëzimeve të komunikimit dhe vizibilitetit të KIBP-it bashkëlidhur si një aneks i marrëveshjes së veçantë të referuar në nenin 7.2.

7.4 Marrësi, përmes Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, ndihmon Agjencinë e Zbatimit të Projektit në përputhje me praktikën e qëndrueshme inxhinierike dhe financiare në zbatimin e projektit dhe përmbushjen e detyrimeve të Agjencisë së Zbatimit të Projektit, sipas kësaj marrëveshjeje, dhe në veçanti, do t'i japë Agjencisë së Zbatimit të Projektit të gjitha lejet e nevojshme për zbatimin e projektit.

7.5 Marrësi, përmes Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe/ose Agjencia e Zbatimit të Projektit mund të marrin parasysh, sipas rastit dhe me përgjegjësinë e vet, informacionin e përfshirë në Sistemin e Zbulimit të Hershëm dhe Përrjashtimit, kur jep kontrata. Aksesin në informacion mund të sigurohet përmes personave të autorizuar ose konsultimit me Komisionin Evropian.

Neni 8

Publikimi dhe transferimi i informacionit të lidhur me projektin

8.1 Për të qenë në përputhje me parimet e pranuar në nivel ndërkombëtar për transparencë dhe efikasitet maksimal në bashkëpunimin për zhvillim, KfW-ja publikon informacionin e përzgjedhur (duke përfshirë rezultatet e kategorizimit dhe vlerësimit mjedisor dhe shoqëror, si dhe raportet e vlerësimit *ex post* (pas projektit)) për projektin dhe mënyrën sesi është financuar gjatë negociatave parakontraktuale, ndërsa zbatohen marrëveshjet lidhur me projektin dhe me fazën paskontraktuale (në vijim e referuar si "Periodha e plotë").

Informacioni publikohet rregullisht në faqen e internetit të Bankës për Zhvillim të KfW-së <http://transparenz.KfW-entwicklungsbank.de/>.

Publikimi i informacionit (ose nga KfW-ja apo palët e treta, në përputhje me nenin 8.3 më poshtë, në lidhje me projektin dhe mënyrën e financimit të tij nuk përfshin asnjë dokumentacion kontraktual ose informacion të



detajuar sensitiv financiar ose biznesi në lidhje me palët e përfshira në projekt ose financimin e tij, të tilla si:

- a) informacion për të dhëna të brendshme financiare;
- b) strategji biznesi;
- c) udhëzime dhe raportet e brendshme të korporatës;
- d) të dhënat personale të personave fizikë;
- e) vlerësimin e brendshëm të KfW-së për gjendjen financiare të palëve.

8.2 KfW-ja ndan informacione të përzgjedhura mbi projektin dhe mënyrën sesi është financuar gjatë periudhës së plotë, veçanërisht për të garantuar transparencë dhe efikasitet me subjektet e poshtëshënuara:

- a) filialet e KfW-së;
- b) Republikën Federale të Gjermanisë dhe organet e saj kompetente, autoritetet, institucionet, agjencitë ose subjektet;
- c) organizata të tjera zbatuese të përfshira në bashkëpunimin gjerman dypalësh për zhvillim, veçanërisht Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH;
- d) organizata ndërkombëtare të përfshira në mbledhjen e të dhënave statistikore dhe anëtarëve të tyre, në veçanti, Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD) dhe anëtarët e saj;
- e) palët në kushtet e përgjithshme të FPEBP-së;
- f) institucionet që administrojnë FPEBP-në;
- g) Bashkimin Evropian dhe institucionet e tij.

8.3 Gjithashtu, Republika Federale e Gjermanisë i ka kërkuar KfW-së të ndajë informacionin e përzgjedhur për projektin dhe mënyrën sesi financohet gjatë periudhës së plotë me subjektet e mëposhtme që publikojnë seksionet që lidhen me qëllimin:

- a) Republika Federale e Gjermanisë për qëllimet e iniciativës së transparencës së ndihmës Ndërkombëtare:

(http://www.bmz.de/de/ministerium/zahlen_f_akten/transparenz-fuer-mehr-Wirksamkeit/Transparenzstrategie/index.html);

- b) Tregu. & Investimi Gjerman (GTAI) për qëllimet e informacionit për tregun: (http://www.gtai.de/GTAI/Navigation/DE/trad_e.FOO);

- c) OECD-ja për qëllimet e raportimit të flukseve financiare në kuadrin e bashkëpunimit për zhvillim: (<http://stats.oecd.org/>);

- d) Instituti Gjerman për Vlerësimin e Zhvillimit (DEVal) për qëllimet e vlerësimit të përgjithshëm të bashkëpunimit gjerman për zhvillim, për të garantuar transparencë dhe efikasitet (<http://www.deval.org/de/>);

- e) palët në kushtet e përgjithshme të FPEBP-së;

- f) institucionet që administrojnë FPEBP-në;

- g) Bashkimin Evropian dhe institucionet e tij.

8.4 KfW-ja, gjithashtu, rezervon të drejtën për të transferuar (duke përfshirë edhe për qëllimet e publikimit) informacion në lidhje me projektin dhe mënyrën se si financohet ai gjatë periudhës së plotë ndaj palëve të treta, me qëllim mbrojtjen e interesave të ligjshëm.

Informacioni nuk transferohet nga KfW-ja tek palët e treta, nëse interesat e ligjshëm të marrësit në informacionin që nuk transferohet i tejkalojnë interesat e KfW-së për transferimin e këtij informacioni. Interesat e ligjshëm të marrësit, në veçanti, përfshijnë konfidencialitetin e informacioneve sensitive të përmendura në nenin 8.1, i cili përjashtohet nga publikimi.

Gjithashtu, KfW-ja ka të drejtë të transferojë informacion tek palët e treta, nëse kjo është e nevojshme për shkak të kërkesave ligjore ose rregullatore, ose për të pohuar, ose mbrojtur pretendimet ose të drejtat e tjera ligjore në gjykatë apo procedime administrative.

Neni 9

Dispozita të ndryshme

9.1 Marrësi ndërmerr të përbushë në çdo kohë detyrimet e përcaktuara në aneksin 1a (zotimet e përputhshmërisë së marrësit), Agjencia e Zbatimit të Projektit ndërmerr të përbushë në çdo kohë detyrimet e përcaktuara në aneksin 1b (zotimet e përputhshmërisë të agjencisë së zbatimit të projektit).

9.2 Nëse ndonjë nga dispozitat e kësaj marrëveshjeje është e pavlefshme, të gjitha dispozitat e tjera do të mbeten të pacenuara në lidhje me të. Çdo boshllëk ligjor që mund të rrjedhë prej saj plotësohet me një dispozitë në pajtim me qëllimin e kësaj marrëveshjeje.



9.3 Marrësi dhe Agjencia e Zbatimit të Projektit nuk mund të delegojë ose transferojë, rendojë me peng ose hipotekë ndonjë pretendim nga kjo marrëveshje.

9.4 Kjo marrëveshje rregullohet nga legjislacioni i Republikës Federale të Gjermanisë. Vendi i përmbushjes është Frankfurt am Main.

9.5 Marrëdhëniet juridike të vendosura nga kjo marrëveshje ndërmjet KfW-së, marrësit dhe Agjencisë së Zbatimit të Projektit do të përfundojnë me mbarimin e kohëzgjatjes së dobishme të projektit, por jo më vonë se 15 vjet pas nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje.

9.6 Kjo marrëveshje nuk do të hyjë në fuqi dhe efekt deri në datën kur KfW-ja të ketë marrë njoftimin me shkrim nga marrësi, që procedurat e brendshme ligjore që duhet të përmbushen nga marrësi kanë përfunduar (data e marrjes të KfW-ja).

Hartuar në tre (3) origjinale, në gjuhën angleze.

Sot, më 28 janar 2022.

KfW Frankfurt am Main,

Emri: Brit Horschke.

Pozicioni: Drejtori KfW i vendit

Emri: Sarah Borgard

Pozicioni: Manaxheri Kryesor i Portofolit

Tiranë,

Sot më 28 janar 2022

Republika e Shqipërisë, e përfaqësuar

nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Emri: Delina Ibrahimaj, Shqipëri

Pozicioni: Ministër i Financave dhe

Ekonomisë

Korporata Elektroenergjetike Shqiptare
(KESH)

Emri: Ergys Verdho

Pozicioni: Administrator i KESH sh.a.

Shtojca

Shtojca 1a: Zotimet e Përputhshmërisë të marrësit

Shtojca 1b: Zotimet e Përputhshmërisë të Agjencisë së Zbatimit të Projektit

Shtojca 1a

ZOTIMET E PËRPUTHSHMËRISË SË MARRËSIT

1. PËRKUFIZIME

Praktikë shtrënguese: dëmtimi apo lëndimi ose kërcënimimi për të dëmtuar apo lënduar, drejtpërdrejt ose tërthorazi, një person apo pronë të ndonjë personi për të ndikuar në mënyrë të papërshtatshme mbi veprimet e një personi.

Praktikë e fshehtë: është një marrëveshje midis dy apo më shumë personave, me qëllim arritjen e një synimi të papërshtatshëm, duke përfshirë ndikimin e papërshtatshëm në veprimet e një personi tjetër.

Praktikë korruptive: premtimi, ofrimi, dhënia, kryerja, insistimi për të dhënë, marrja, pranimi ose kërkimi, qoftë drejtpërdrejt ose tërthorazi, i ndonjë pagese të jashtëligjshme ose avantazhi të papërshtatshëm të çfarëdolloj natyre, për apo nga çdo person, me qëllim ndikimin në veprimet e një personi apo pengimin e atij personi për të vepruar.

Praktikë mashtruese: nënkupton çdo veprim ose mosveprim, duke përfshirë një keqpërfaqësim që çorienton ose synon të çorientojë, qoftë me ose pa dashje, një person me qëllim marrjen e një përfitimi financiar ose shmangien e një detyrimi.

Praktikë penguese: i. shkatërrimi, falsifikimi, ndryshimi ose fshehja e qëllimshme e provave materiale hetimore ose dhënia e dëshmive të rreme për hetuesit, për të penguar materialisht një hetim zyrtar mbi dyshimet e një praktike korruptive, praktike mashtruese, praktike shtrënguese, praktike të fshehtë ose kërcënimimi, ngacmimi apo frikësimi të një personi për të mos e lejuar atë që të tregojë gjithçka për çështje që lidhen me hetimin, ose nga kryerja e hetimit; ose ii. çdo akt që synon të pengojë materialisht ushtrimin e aksesit të KfW-së në informacionin e kërkuar kontraktualisht lidhur me një hetim zyrtar mbi dyshimet e një praktike korruptive, praktike mashtruese, praktike shtrënguese ose praktike të fshehtë.



Person: një person fizik, person juridik, partneritet apo shoqatë e pathemeluar në formën e korporatës.

Praktikë e sanksionueshme: çdo praktikë shtrënguese, praktikë e fshehtë, praktikë korruptive, praktike mashtruese, ose praktike penguese (sipas kushteve të përcaktuara në këtë marrëveshje) që: i. është e paligjshme sipas legjislacionit gjerman ose ligjeve të tjera të zbatueshme; dhe që ii. ka ose mund të ketë efekt material ligjor ose reputacional mbi këtë Marrëveshje ndërmjet marrësit dhe KfW-së apo zbatimin e saj.

Sanksione: sanksionet, ligjet, rregulloret, embargot apo masat shtrënguese ekonomike, financiare ose tregtare, të administruara, miratuara apo zbatuara nga organi sanksionues.

Organ sanksionues: Këshilli i Sigurimit i Organizatës së Kombeve të Bashkuara, Bashkimi Evropian ose Republika Federale e Gjermanisë.

Listë e sanksioneve: çdo listë e personave, grupeve apo subjekteve të përcaktuara në mënyrë specifike që i nënshtrohen sanksioneve, e lëshuar nga ndonjë organ sanksionues.

2. SIPËRMARRJA LIDHUR ME INFORMACIONIN

Marrësi, përmes Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë:

a) i vë në dispozicion KfW-së menjëherë, sipas kërkesës së kësaj të fundit, të gjithë informacionin përkatës që lidhet me “njohjen e klientit” apo informacione të ngjashme për marrësin që KfW-ja mund të kërkojë;

b) i ofron KfW-së menjëherë, sipas kërkesës, të gjithë informacionin dhe dokumentet e lidhura me projektin, të marrësit dhe palëve të tij (nën)kontraktuese dhe palëve të tjera përkatëse, tek të cilat KfW-ja bazohet për të përmbushur detyrimet e saj për parandalimin e praktikave të sanksionueshme, pastrimin e parave, ose financimin e terrorizmit, si dhe për monitorimin e vazhdueshëm të marrëdhënies së biznesit me marrësin që është e nevojshme për këtë qëllim;

c) informon KfW-në menjëherë dhe me pëlqimin e tij, sapo merr dijeni apo dyshon për ndonjë praktikë të sanksionueshme, akt pastrimi parash dhe/ose financim terrorizmi të lidhur me projektin;

d) i jep KfW-së çdo dhe të gjitha informacionet dhe raportet mbi projektin dhe ecurinë e tyre të

mëtejshme, siç KfW-ja mund të kërkojë, për qëllimet e kësaj Shtojce; dhe

e) i mundëson KfW-së dhe agjentëve të saj, në çdo kohë, inspektimin e të gjithë dokumentacionit tjetër të marrësin dhe palëve të tij (nën)kontraktuese apo palëve të tjera të lidhura me të mbi programin dhe kryerjen e vizitave në projekt dhe në të gjitha instalimet përkatëse, për qëllimet e kësaj shtojce.

3. PËRFAQËSIMI DHE GARANCIA

3.1 Për sa i përket legjislacionit gjerman apo legjislacionit të vendit të marrësit, ky i fundit shprehet se asnjë prej personave që vepron në emër të marrësit për projektin, nuk ka kryer ose nuk është angazhuar në praktikë të sanksionueshme, pastrim parash apo financim terrorizmi.

3.2 Përfaqësimi dhe garancia e përcaktuar në këtë nen jepen për herë të parë me zbatimin e kësaj marrëveshjeje. Ato do të konsiderohen të përsëritura me çdo tërheqje të huas dhe në çdo datë të Pagesës së Interesit, duke iu referuar rrethanave mbizotëruese në atë datë.

4. SIPËRMARRJET POZITIVE

Marrësi ndërmerr të bashkëpunojë plotësisht me KfW-në dhe agjentët e saj sapo marrësi apo KfW-ja të marrë dijeni apo të dyshojë për ndonjë praktikë të sanksionueshme, akt pastrimi parash, apo financim terrorizmi, për të përcaktuar nëse ka ndodhur ky incident përputhshmërie. Në veçanti, marrësi i përgjigjet menjëherë dhe në detaje të arsyeshme çdo njoftimi të KfW-së dhe ofron mbështetje dokumentuese për këtë përgjigje, me kërkesë të KfW-së.

5. SIPËRMARRJET NEGATIVE

Marrësi nuk lidh transaksione apo nuk angazhohet në veprimtari të tjera lidhur me projektin që përbëjnë shkelje të sanksioneve.

Shtojca 1b

ZOTIMET E PËRPUTHSHMËRISË SË AGJENCISË SË ZBATIMIT TË PROJEKTTIT

1. PËRKUFIZIMET

Praktikë shtrënguese: dëmtimi apo lëndimi ose kërcënim i për të dëmtuar apo lënduar, drejtpërdrejt ose tërthorazi, ndonjë person apo pronë të personit për të ndikuar në mënyrë të papërshtatshme në veprimet e një personi.



Praktikë e fshehtë: një marrëveshje midis dy apo më shumë personave, me qëllim arritjen e një synimi të papërshtatshëm, duke përfshirë ndikimin e papërshtatshëm në veprimet e një personi tjetër.

Praktikë korruptive: premtimi, ofrimi, dhënia, kryerja, insistimi për të dhënë, marrja, pranimi ose kërkimi, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i ndonjë pagese të jashtëligjshme ose avantazhi të papërshtatshëm të çfarëdolloj natyre, për apo nga ndonjë person, me qëllim ndikimin në veprimet e një personi apo pengimin e ndonjë personi për të vepruar.

Kategoritë e përcaktuara të veprave penale: kategoritë e mëposhtme të veprave penale, të përcaktuara sipas Rekomandimeve të FATF-së dhe shënimit përkatës interpretues: pjesëmarrja në një grup kriminal të organizuar dhe shantazhim; terrorizmi, duke përfshirë financimin e terrorizmit; trafikimi i qenieve njerëzore dhe kontrabandimi i emigrantëve; shfrytëzimi seksual, duke përfshirë shfrytëzimin seksual të fëmijëve; trafikimi i paligjshëm i lëndëve narkotike dhe substancave psikotrope; trafikimi i paligjshëm i armëve; trafikimi i paligjshëm i mallrave të vjedhur dhe mallrave të tjerë; korrupsioni dhe mitmarrja/mitdhënia; mashtrimi; falsifikimi i monedhës; falsifikimi dhe pirateria e produkteve; krimi mjedisor; vrasja, lëndimi i rëndë trupor; rrëmbimi; mbajtja e paligjshme me forcë dhe pengmarrja; grabitja ose vjedhja; kontrabandimi (duke përfshirë edhe në lidhje me taksat dhe tarifatat doganore dhe akcizat); krimet tatimore (të lidhura me taksat direkte dhe të tërthorta); zhvatja; falsifikimi, pirateria; manipulimi i tregut dhe tregtimi i brendshëm.

Rekomandimet e FATF-së: rekomandime të tilla që përcaktohen herë pas here nga Task-Forca e Veprimit Financiar (FATF) FATF është organi ndërqeveritar, qëllimi i të cilës është hartimi dhe nxitja e politikave kombëtare dhe ndërkombëtare për luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Praktikë mashtruese: nënkupton çdo veprim ose mosveprim, duke përfshirë një keqinterpretim që me qëllim ose nga pakujdesia çorienton ose synon të çorientojë një palë në kuadrin e marrjes së një përfitimi financiar ose shmangies së një detyrimi;

Origjinë e paligjshme: origjina e fondeve të përfuara me anë të:

a) ndonjë veprë penale të listuar në kategoritë e caktuara të veprave penale;

b) ndonjë praktike korruptive;

c) ndonjë praktike mashtruese; ose

d) pastrimit të parave.

Praktikë penguese: i. shkatërrimi, falsifikimi, ndryshimi ose fshehja e qëllimshme e materialit të provave për hetimin ose dhënia e deklaratave të rreme hetuesve, në mënyrë që të pengohet materialisht një hetim zyrtar për dyshimet për një praktikë korruptive, mashtruese, shtrënguese ose të fshehtë, ose kërcënim, ngacmimi apo frikësimi i ndonjë pale për ta parandaluar atë nga zbulimi i njohurive të saj për çështje që lidhen me hetimin apo ndjekjen e hetimit; ose ii. çdo veprim i synuar për të penguar materialisht ushtrimin e aksesit të KfW-së në informacionin e kërkuar kontraktualisht në lidhje me një hetim zyrtar për dyshimet e një praktike korruptive, mashtruese, shtrënguese ose të fshehtë.

Person: çdo person fizik, person juridik, partneritet ose shoqatë e pathemeluar.

Praktikë e sanksionueshme: çdo praktikë shtrënguese, praktikë e fshehtë, praktikë korruptive, praktikë mashtruese ose praktikë penguese (sipas kushteve të përcaktuara në këtë marrëveshje) që: i. është e paligjshme sipas legjislacionit gjerman ose legjislacioni tjetër të zbatueshëm; dhe që ii. ka ose mund të ketë efekt material ligjor ose reputacional mbi këtë Marrëveshje ndërmjet Agjencisë së Zbatimit të Projektit dhe KfW-së apo zbatimin e saj.

Sanksionet: sanksionet, ligjet, rregulloret, embargot apo masat shtrënguese ekonomike, financiare ose tregtare, të administruara, miratuara apo zbatuara nga ndonjë organ sanksionues.

Organ sanksionues: Këshilli i Sigurimit i Organizatës së Kombeve të Bashkuara, Bashkimi Evropian dhe Republika Federale e Gjermanisë.

Listë e sanksioneve: çdo listë e personave, grupeve apo subjekteve të përcaktuara në mënyrë specifike që i nënshtrohen sanksioneve, e lëshuar nga ndonjë organ sanksionues.

2. SIPËRMARRJE NË LIDHJE ME INFORMACIONIN

Agjencia e Zbatimit të Projektit:

a) i vë në dispozicion KfW-së menjëherë, sipas kërkesës së kësaj të fundit, të gjithë informacionin përkatës që lidhet me “njohjen e klientit” apo informacione të ngjashme për Agjencinë e Zbatimit



të Projektit dhe të ndonjë (në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe/ose të tërthortë) aksioneri, filiali dhe/ose bashkëpunëtori tjetër të tij (nëse ka);

b) i ofron KfW-së menjëherë, sipas kërkesës, të gjithë informacionin dhe dokumentet e lidhura me projektin, të Agjencisë së Zbatimit të Projektit dhe palëve të saj (nën)kontraktuese dhe palëve të tjera përkatëse, tek të cilat KfW-ja bazohet për të përmbushur detyrimet e saj për parandalimin e praktikave të sanksionueshme, pastrimit të parave ose financimin e terrorizmit, si dhe për monitorimin e vazhdueshëm të marrëdhënies së biznesit me Agjencinë e Zbatimit të Projektit që është e nevojshme për këtë qëllim;

c) informon KfW-në menjëherë dhe me pëlqimin e saj, sapo merr dijeni apo dyshon për ndonjë praktikë të sanksionueshme, akt pastrimi parash dhe/ose financim terrorizmi nga Agjencia e Zbatimit të Projektit, anëtarët e organeve të saj të menaxhimit, organeve të tjera qeverisëse apo aksionerëve të saj;

d) i jep KfW-së çdo dhe të gjitha informacionet dhe raportet për projektin dhe ecurinë e tij të mëtejshme, sipas kërkesës së KfW-së, për qëllimet e kësaj shtojce;

e) i mundëson KfW-së dhe agentëve të saj inspektimin në çdo kohë të të gjithë dokumentacionit tjetër të lidhur me projektin, të Agjencisë së Zbatimit të Projektit dhe palëve të saj (nën)kontraktuese apo palëve të tjera të lidhura me të dhe kryerjen e vizitave në projekt dhe në të gjitha instalimet përkatëse, për qëllimet e kësaj shtojce.

f) informon KfW-në menjëherë dhe me pëlqimin e saj për çdo rast që mund të sjellë klasifikimin ekzistues ose të mundshëm të Agjencisë së Zbatimit të Projektit, anëtarëve të organeve të saj të menaxhimit ose organeve të tjera qeverisëse apo aksionerëve të saj, si shtetas me emërtim të veçantë, ose personave apo subjekteve të bllokuar, të renditur në ndonjë lloj liste sanksionesh.

3. PËRFAQËSIMET DHE GARANCITË

3.1 Për sa i përket legjislacionit gjerman ose vendit të themelimit të Agjencisë së Zbatimit të Projektit, kjo e fundit përfaqëson dhe garanton se janë të vërteta dhe të sakta sa më poshtë:

a) në zbatimin e kësaj marrëveshjeje huaje, Agjencia e Zbatimit të Projektit vepron në emrin e saj dhe për llogari të vet;

b) në dijeni të saj dhe vetëm në lidhje me aksionerët që njihen nga Agjencia e Zbatimit të Projektit sipas rregulloreve të zbatueshme të bursës, as kapitali i Agjencisë së Zbatimit të Projektit, as fondet e investuara në projekt nuk kanë burim të paligjshëm;

c) Agjencia e Zbatimit të Projektit, bashkëpunëtorët, filialet apo asnjë person tjetër që vepron në emër të saj nuk ka kryer apo nuk është angazhuar në praktikë të sanksionueshme, pastrim parash apo financim terrorizmi;

d) Agjencia e Zbatimit të Projektit nuk: i. ka lidhur ndonjë marrëdhënie biznesi me shtetas me emërtim të veçantë apo persona dhe subjekte të bllokuar të renditur në ndonjë lloj liste sanksionesh; ose nuk ii. është angazhuar në veprimtari të tjera që përbëjnë shkelje të sanksioneve.

3.2 Përfaqësimet dhe garancitë e përcaktuara në këtë nen jepen për herë të parë me zbatimin e kësaj marrëveshjeje. Ato konsiderohen të përsëritura me çdo tërheqje huaje dhe në çdo datë të pagesës së interesit duke iu referuar rrethanave mbizotëruese në atë datë.

4. SIPËRMARRJET POZITIVE

Agjencia e Zbatimit të Projektit ndërmerr të:

a) përmbushë plotësisht standardet kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, në përputhje me rekomandimet e FATF-së dhe të zbatojë, respektojë dhe përmirësojë, nëse është e nevojshme, standardet dhe udhëzimet e brendshme (duke përfshirë pa kufizim, në lidhje me përmbushjen e detyrimeve ndaj klientit), të nevojshme për shmangien e praktikave të sanksionueshme, akteve të pastrimit të parave ose financimit të terrorizmit; dhe

b) sapo Agjencia e Zbatimit të Projektit ose KfW-ja të marrë dijeni apo të dyshojë për ndonjë praktikë të sanksionueshme, akt pastrimi parash apo financim terrorizmi, bashkëpunon plotësisht me KfW-në dhe agentët e saj, për të përcaktuar nëse ka ndodhur ky incident përputhshmërie. Agjencia e Zbatimit të Projektit i përgjigjet menjëherë dhe me detaje të arsyeshme çdo njoftimi të KfW-së dhe ofron mbështetje dokumentuese për këtë përgjigje, me kërkesë të KfW-së.

5. SIPËRMARRJET NEGATIVE

Agjencia e Zbatimit të Projektit ndërmerr të:

a) sigurojë se kapitali apo fondet e tjera që investon nuk kanë burim të paligjshëm;



b) sigurojë se biznesi i saj nuk shkakton praktikë të sanksionueshme, pastrim parash apo financim terrorizmi; dhe

c) mos lidhë apo të mos vijojë asnjë marrëdhënie biznesi me shtetas me emërtim të veçantë, persona ose subjekte të bllokuar, të renditur në ndonjë listë sanksionesh ose të mos angazhohet në veprimtari të tjera që përbëjnë shkelje të sanksioneve.

VENDIM

Nr.263, datë 29.4.2022

PËR MIRATIMIN E LETËRMARRËVESHJES SË GRANTIT NR.TF0B5581, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM, PËR PROJEKTIN E FORCIMIT TË CILËSISË SË AUDITIMIT DHE RAPORTIMIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr.43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e letërmarrëveshjes së grantit nr.TF0B5581, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për projektin e forcimit të cilësisë së auditimit dhe raportimit sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj**

Logo **BANKA BOTËRORE**

BNRZH – IDA GRUPI I BANKËS BOTËRORE

21 shkurt 2022

SH. S. ZNJ. Delina Ibrahimaj
Ministre e Financave dhe Ekonomisë
Ministria e Financave dhe Ekonomisë
“Dëshmorët e Kombit” Blv. Nr. 3,
Tiranë
Republika e Shqipërisë

**Shqipëria: Granti Nr. TF0B5581
Projekti për Forcimin e Cilësisë së
Auditimit dhe Raportimit
Letër Marrëveshje**

Shkëlqesi,

Shpreh kënaqësinë t’iu informoj se Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim dhe Shoqata Ndërkombëtare për Zhvillim (“Banka Botërore”) që vepron si administratore e fondeve të grantit të ofruara nga Sekretariati i Shtetit për Çështjet Ekonomike (SECO) i Departamentit Federal të Çështjeve Ekonomike, Arsimit dhe Kërkimit (“Donatori”) nën kujdesin e Shqipërisë: Faza e III e Raportimit Financiar të Korporatave – Fondi i Besimit i Donatorit të Vetëm (TF073611), propozon t’i ofrojë Marrësit një grant në shumën që nuk kalon vlerën një milion e katërqind e njëzet e dy mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e një Euro (EURO 1,428,571) (“Granti”) sipas termave dhe kushteve të përcaktuara apo të përmendura në këtë letër marrëveshje (“Marrëveshja”) që përfshin Aneksin bashkëlidhur, për të ndihmuar në financimin e projektit të përshkruar në Shtojcë (“Projekti”).

Ky Grant financohet nga fondi i besimit i lartpërmendur për të cilin Banka merr kontribute periodike nga Donatori. Në përputhje me Seksionin 3.02 të Kushteve Standarde (siç përcaktohet në Aneksin e kësaj Marrëveshjeje), detyrimet e Bankës për kryerjen e pagesës në lidhje me këtë Marrëveshje kufizohen në shumën e fondeve që i janë vënë në dispozicion nga Donatori, sipas fondit të Besimit të lartpërmendur, dhe e drejta e Marrësit për të tërhequr të ardhurat e Grantit është objekt i disponueshmërisë së këtyre fondeve.



Marrësi përfaqëson, duke konfirmuar miratimin e tij më poshtë, se është i autorizuar të lidhë këtë Marrëveshje dhe të zbatojë projektin në përputhje me termat dhe kushtet e përcaktuara apo të përmendura në këtë Marrëveshje.

**1818 H Street NW- Washington,
DC 20433 USA**

Ju lutem konfirmoni pëlqimin e Marrësit sa më poshtë, duke pasur nënshkrimin e një zyrtari të autorizuar të Marrësit dhe datën e kësaj Marrëveshjeje, dhe duke i dërguar Bankës një kopje të nënshkruar sipas rregullave. Pas marrjes së kopjes së kundërfirmosur, kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën kur Marrësi njofton me shkrim Bankën mbi përfundimin e procedurave të tij të brendshme (Data e hyrjes në fuqi).

Me respekt,

**BANKA NDËRKOMBËTARE PËR
RINDËRTIM DHE ZHVILLIM DHE
SHOQATA NDËRKOMBËTARE PËR
ZHVILLIM**

Nga: *(nënshkrimi)*
Linda Van Gelder
Drejtoresh Rajonale,

RËNË DAKORD:

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Nga: Delina Ibrahim
Përfaqësues i Autorizuar
Emri: Delina Ibrahim
Funksioni: Ministër i Financave dhe Ekonomisë
Data: 23.03.2022

Bashkëlidhur:

(1) “Kushtet Standarde të Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim, për Financimin e Grantit të ofruar nga Banka nga Fondet e Besimit”, datë 25 shkurt 2019.

(2) Letra e Disbursimit dhe Informacionit Financiar të së njëjtës date si të kësaj Marrëveshjeje, së bashku me “Udhëzimet e

Disbursimit për Financimin e Projektit të Financimit”, shkurt 2017.

**Numri i Grantit TF0B5581
ANEKS**

Neni I

Kushtet Standarde; Përkufizimet

1.01. Kushtet Standarde. Kushtet Standarde (siç përcaktohen në Seksionin 1.02 më poshtë) përbëjnë pjesë integrale të kësaj Marrëveshjeje.

1.02. Përkufizimet. Përveç kur konteksti e kërkon ndryshe, termat me shkronjë të madhe në këtë Marrëveshje kanë kuptimet që u janë dhënë në Kushtet Standarde ose në këtë Seksion:

a) “Udhëzime Anti-Korrupsion” do të thotë, për qëllimet e paragrafit 2 të Shtojcës të Kushteve Standarde, “Udhëzimet për Parandalimin dhe Luftën kundër Mashtrimit dhe Korrupsionit në Projekte të Financuara nga Huatë e BNRZH-së dhe Kreditë dhe Grantet e IDA-s”, datë 15 tetor 2006 dhe të rishikuara në janar 2011 dhe më 1 korrik 2016.

b) “Kategori” do të thotë kategoria e përcaktuar në tabelën në Seksionin 3.01 të kësaj Marrëveshjeje.

c) “GDFC” do të thotë Drejtoria e Përgjithshme e Financimeve dhe Kontraktimeve të Marrësit, e krijuar nën varësinë e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, për Bashkimin Evropian, Bankën Botërore dhe fondet e donatorëve të tjerë ose ndonjë pasuesi të tyre.

d) “Plan i Angazhimit Mjedisor dhe Social” ose “ESCP” do të thotë plani i angazhimit mjedisor dhe social i Marrësit për Projektin, i datës 18 nëntor 2020, siç mund të ndryshohet herë pas here në përputhje me dispozitat e tij, i cili përcakton masat materiale dhe veprimet që Marrësi kryen ose merr masa të kryhen për të trajtuar rreziqet dhe ndikimet e mundshme mjedisore dhe sociale të Projektit, duke përfshirë afatet kohore të veprimeve dhe masave, angazhimet institucionale, të stafit, trajnimit, monitorimit dhe raportimit dhe çdo instrument mjedisor dhe social që duhet të përgatitet më pas.

e) “Standarde Mjedisore dhe Sociale” “ose ESS” do të thotë bashkërisht: (j) “Standardi Mjedisor dhe Social 1: Vlerësimi dhe Menaxhimi i Rreziqeve dhe Ndikimeve Mjedisore dhe Sociale”; (ii) “Standardi Mjedisor dhe Social 2: Puna dhe



Kushtet e Punës”; (iii) “Standardi Mjedisor dhe Social 3: Efektshmëria e Burimeve dhe Parandalimi dhe Menaxhimi i Ndotjes”; (iv) “Standardi Mjedisor dhe Social 4: Shëndeti dhe Siguria e Komunitetit”; (v) “Standardi Mjedisor dhe Social 5: Blerja e Tokës, Kufizimet mbi Përdorimin e Tokës dhe Rivendosja e Pavullnetshme”; (vi) “Standardi Mjedisor dhe Social 6: Ruajtja e Biodiversitetit dhe Menaxhimi i Qëndrueshëm i Burimeve Natyrore të Jetesës”; (vii) “Standardi Mjedisor dhe Social 7: Popujt Indogjenë/ Komunitetet Lokale Tradicionale Nën-Sahariane Historikisht Vulnerabil”; (viii) “Standardi Mjedisor dhe Social 8: Trashëgimia Kulturore”; (ix) “Standardi Mjedisor dhe Social 9: Ndërmjetësit Financiarë”; (x) “Standardi Mjedisor dhe Social 10: Angazhimi i Palëve të Interesit dhe Zbulimi i Informacionit”, në fuqi që nga data 1 tetor 2018, siç publikohet nga Banka.

f) “MoFE” do të thotë Ministria e Financave dhe Ekonomisë e Marrësit ose ndonjë pasues i saj.

g) “NSC” do të thotë Komiteti Kombëtar Drejtues që duhet të krijohet nga Marrësi, siç përmendet më tej në Seksionin 2.03 (A) të Aneksit të kësaj Marrëveshjeje.

h) “Kosto Operative” do të thotë shpenzimet e arsyeshme, siç janë miratuar nga Banka, të shkaktuara nga Marrësi për të financuar shpenzimet e tyre shtesë, të kryera në kuadër të zbatimit të Projektit dhe që përfshijnë, *ndër të tjera*, funksionimin dhe mirëmbajtjen e automjeteve, kostot e komunikimit dhe sigurimit, tarifat bankare, shpenzimet e qirasë, mirëmbajtjen e zyrës dhe pajisjet e zyrës (por duke përjashtuar punime të vogla), shërbimet, dublikimin/ printimin e dokumenteve, pajisjet e konsumit, kostot e udhëtimit dhe dietat për personelin e Projektit për udhëtimet e lidhura me zbatimin e Projektit dhe pagat e personelit kontraktues për Projektin (por duke përjashtuar shërbimet e konsulencës dhe punonjësve publikë) dhe çdo shpenzim tjetër të arsyeshëm, siç mund të bihet dakord nga Banka Botërore.

i) “Rregullore Prokurimi” do të thotë, për qëllime të paragrafit 20 të Shtojcës së Kushteve Standarde, “Rregulloret e Prokurimit të Bankës Botërore për Huamarrësit IPF”, nëntor 2020.

j) “Manual i Operimit të Projektit” dhe “POM” do të thotë manuali që duhet të përgatitet nga Marrësi, duke përfshirë të gjitha shtojcat dhe

skedulet e tij, të pranueshme për Bankën Botërore, i cili përcakton politikat dhe procedurat që zbatohen për kryerjen e Projektit, siç përmendet më tej në Seksionin 2.03 (B) të Shtojcës së kësaj Marrëveshjeje.

k) “RIG” do të thotë Grupi për Zbatimin e Reformës, i krijuar nga Marrësi, siç përmendet më tej në Seksionin 2.03 (A) të Aneksit të kësaj Marrëveshjeje.

l) “Kushte Standarde” do të thotë “Kushtet Standarde të Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim, për Financimin e Grantit të Ofruar nga Banka nga Fondet e Besimit” të datës 25 shkurt 2019.

m) “Trajnim” do të thotë shpenzimet e bëra nga Marrësi për të kryer trajnime, duke përfshirë kostot e shkollimit, udhëtimit dhe dietave për pjesëmarrësit në trajnime dhe seminar, kostot lidhur me sigurimin e shërbimeve të trajnerëve dhe folësve në seminar, qiratë e ambienteve të trajnimit dhe seminarit, përgatitjen dhe riprodhimin e materialeve të trajnimit dhe seminarit, dhe kosto të tjera të lidhura drejtpërdrejt me përgatitjen dhe zbatimin e trajnimit dhe seminarit (por duke përjashtuar mallrat dhe shërbimet e konsulencës).

Neni II

Ekzekutimi i Projektit

2.01. ***Qëllimet dhe Përshkrimi i Projektit.***

Qëllimi i Projektit është forcimi i kapacitetit të Marrësit dhe grupeve përkatëse të interesit për të përmirësuar, aplikuar dhe zbatuar raportimin financiar të korporatave, në përputhje me standardet dhe praktikat e mira ndërkombëtare në Shqipëri.

Projekti konsiston në pjesët e mëposhtme:

a) Forcimi i Vendosjes, Mbikëqyrjes dhe Zbatimit të Standardeve

i) Mbështetja e një numri aktiviteteve për të forcuar kapacitetin për vendosjen e standardit dhe mbikëqyrjen e kontabilitetit, duke përfshirë, *ndër të tjera*: (a) sigurimin e ndihmës teknike për Këshillin Kombëtar të Kontabilitetit (NAC), për zhvillimin e tij dhe zbatimin e një metodologjie për rishikimin e pasqyrave financiare të bazuara në risk; dhe (b) ofrimin e ndihmës teknike dhe trajnimit për Bordin e Mbikëqyrjes Publike (POB), për përmirësimin e kapaciteteve të tij lidhur me kontrollin e sigurimit të



cilësisë, veprimet hetuese dhe disiplinore, dhe monitorimin e organizatave profesionale të kontabilitetit.

ii) Ofrimi i Trajnimit për Bankën e Shqipërisë (BSH) dhe Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare (AMF) për Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (IFRS) dhe përdorimin e instrumenteve elektronike për rishikimin e pasqyrave financiare të IFRS-së.

iii) Ofrimi i ndihmës teknike për zbatimin e qendrës kombëtare të biznesit të Gjuhës së Zgjeruar të Raportimit të Biznesit (XBRL), për të vazhduar përmirësimin e depozitimit dhe publikimit të pasqyrave financiare të bazuara në IFRS.

b) Përmirësimi i Kapacitetit për Pajtuashmërinë me Kërkesat CFR, Zhvillimi i Shërbimeve të Kontabilitetit dhe Ndërgjegjësimi i Publikut

i) Mbështetje për Komisionin e Ekzaminimit (EC) të Shqipërisë, për të përmirësuar proceset e testimit dhe ekzaminimit për kandidatët kontabilistë dhe auditues të kualifikuar, bazuar në praktikatat e mira ndërkombëtare.

ii) Forcimi i profesionit të kontabilistit në Shqipëri, duke ofruar aktivitetet për ndihmë teknike dhe ndërtimin e kapaciteteve, për organizatat e përzgjedhura profesionale të kontabilitetit dhe Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

iii) Kryerja e aktiviteteve për ndërgjegjësimin e publikut për: (a) përfitimet dhe ndikimin e Raportimit Financiar të Korporatave (CFR) dhe rëndësinë e cilësisë së auditimit dhe rolit të komitetit të auditimit; dhe (b) ndikimin e praktikave të mira CFR për ekonominë formale dhe joformale në Shqipëri.

c) Forcimi i Profesionit të Kontabilistit dhe Ndërtimi i Kapaciteteve në Sistemin Gjyqësor

i) Ofrimi i ndihmës teknike për organizatat e përzgjedhura profesionale të kontabilitetit, për të ndërtuar kapacitetin e tyre për të zhvilluar kontabilitetin ligjor, si një fushë e ndarë e shërbimit për organizatat e kontabilitetit në Shqipëri.

ii) Mbështetje për gjykatat shqiptare (të qarkut, apelit, e lartë), prokurorinë e përgjithshme dhe zyrtarët e policisë gjyqësore, mbi teknikat e kontabilitetit, dhe legjislacionin dhe standardet.

d) Menaxhimi i Projektit, Forcimi i Kapaciteteve, Monitorimit dhe Vlerësimit të Reformave

Sigurimi i: (i) Kostove Operative për aktivitetet e menaxhimit, monitorimit dhe vlerësimit të Projektit; dhe (ii) ndihmës teknike për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Financimeve dhe Kontraktimeve, për të forcuar kapacitetin e reformës së tyre CFR.

2.02. Ekzekutimi i Projektit në Përgjithësi. Marrësi deklaron angazhimin e tij për përmbyshjen e qëllimit të Projektit. Në këtë kuadër, Marrësi kryen: (a) aktivitetet e Projektit nëpërmjet strukturës përgjegjëse për harmonizimin e menaxhimit financiar, kontrollit dhe kontabilitetit (e krijuar në MFE); dhe (b) aspekte fiduciare të Projektit nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Financimeve dhe Kontraktimeve, duke përfshirë prokurimet dhe menaxhimin financiar, në përputhje me dispozitat e: (a) Nenit II të Kushteve Standarde; (b) Udhëzimet Anti - Korrupsion; dhe (c) këtë Nen II.

2.03. Angazhimet Institucionale dhe Angazhime të Tjera

A) Komiteti Kombëtar Drejtues (NSC) dhe Grupi i Zbatimit të Reformës (RIG)

Brenda 30 ditë nga Data e Hyrjes në Fuqi, për të lehtësuar zbatimin e Projektit, Marrësi krijon dhe më pas mirëmban gjatë zbatimit të Projektit, Komitetin Kombëtar Drejtues (NSC) dhe Grupin e Zbatimit të Reformave (RIG), me rolin për të mbikëqyrur reformat në fushën e raportimit financiar të korporatave në Shqipëri, me terma reference dhe përbërje të pranueshme për Bankën Botërore, për të mbështetur, *ndër të tjera*, koordinimin ndërsektorial dhe për t'i shërbyer drejtimit të Projektit, ofruar udhëzim dhe rishikim të përgjithshëm të politikave dhe miratuar planet e punës gjashtëmujore dhe raportet gjashtëmujore të progresit të zbatimit të buxheteve, auditimet dhe koordinimin e brendshëm ministror.

B) Manuali i Operimit të Projektit (POM)

1. Brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi, për të lehtësuar zbatimin e Projektit, Marrësi përgatit dhe më pas mirëmban Manualin e Operimit të Projektit ("POM"), në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Bankën Botërore, i cili përcakton procedurat dhe kërkesat operacionale dhe administrative për zbatimin e Projektit, duke përfshirë, *ndër të tjera*: (i) menaxhimin financiar, prokurimin, dhe standardet dhe procedurat mjedisore dhe sociale; personelin, menaxhimin dhe përgjegjësitë e subjekteve të ngarkuar me zbatimin



e Projektit, duke përfshirë detyrat fiduciare; dhe (ii) procedurat për vlerësimin, disbursimin, kontabilitetin dhe auditimin e fondeve sipas Projektit; dhe listën e aktiviteteve që përjashtohen nga financimi, sipas Projektit.

2. Marrësi zbaton Projektin në përputhje me POM. POM nuk mund të caktohet, amendohet, shfuqizohet apo hiqet dorë ose lejohet të caktohet, amendohet, shfuqizohet ose hiqet dorë ose ndonjë dispozite të saj, në një mënyrë që sipas opinionit të Bankës Botërore, mund të amendohet vetëm në konsultim me dhe pas miratimit të Bankës Botërore. Në rast të ndonjë mosmarrëveshjeje ndërmjet termave të POM dhe atyre të kësaj Marrëveshjeje, termat e kësaj Marrëveshjeje do të kenë përparësi.

2.04. Standardet Mjedisore dhe Sociale

a) Marrësi siguron se Projekti zbatohet në përputhje me Standardet Mjedisore dhe Sociale, në një mënyrë të pranueshme për Bankën.

b) Pa kufizim në paragrafin (a) më lart, Marrësi siguron se:

i) merren të gjitha masat e nevojshme për të mbledhur, hartuar dhe furnizuar Bankën nëpërmjet raporteve të rregullta, sipas shpeshtësisë së specifikuar në ESCP dhe menjëherë në një raport ose raporte të ndara, nëse kjo kërkohet nga Banka, me informacionin mbi statusin e pajtueshmërisë me ESCP-në dhe instrumentet mjedisore dhe sociale të përmendura aty, ku të gjitha këto raporte në formë dhe përmbajtje janë të pranueshme për Bankën, duke përcaktuar, ndër të tjera: (A) statusin e zbatimit të ESCP-së; (B) kushtet, nëse ka, që ndërhyjnë ose rrezikojnë të ndërhyjnë në zbatimin e ESCP-së; dhe (C) masat korrigjuese dhe parandaluese që merren ose që duhet të merren për të trajtuar këto kushte; dhe

ii) Banka njoftohet menjëherë për çdo aksident ose incident lidhur me ose që ka ndikim tek Projekti, që ka ose mund të ketë ndikim negativ të konsiderueshëm tek mjedisi, komunitetet e prekura, publiku ose punëtorët, në përputhje me ESCP-në, instrumentet mjedisore dhe sociale të përmendura aty dhe Standardet Mjedisore dhe Sociale.

c) Marrësi krijon, publikon, mirëmban dhe operon një mekanizëm të aksesueshëm për zgjidhjen e ankesave, për të marrë dhe lehtësuar zgjidhjen e shqetësimeve dhe ankesave të personave të prekur nga Projekti, dhe merr të gjitha masat e nevojshme dhe të duhura për të zgjidhur ose lehtësuar zgjidhjen e këtyre shqetësimeve dhe ankesave, në një mënyrë të pranueshme për Bankën.

2.05. Monitorimi, Raportimi dhe Vlerësimi i Projektit. Marrësi, nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme së Financimeve dhe Kontraktimeve, siguron se çdo Raport i Projektit i jepet Bankës jo më vonë se një (1) muaj pas çdo tremujori kalendarik që mbulon tremujorin kalendarik.

Neni III

Tërheqja e të Ardhurave nga Granti

3.01. **Shpenzimet e Pranueshme.** Marrësi mund të tërheqë të ardhurat e Grantit në përputhje me dispozitat e: (a) Nenit III të Kushteve Standarde dhe (b) këtij Seksioni; për të financuar Shpenzimet e Pranueshme në shumën e alokuar dhe, nëse është e zbatueshme, deri në përqindjen e përcaktuar ndaj çdo Kategorie të tabelës së mëposhtme:

Kategoria	Shuma e Grantit e alokuar (e shprehur në EURO)	Përqindja e Shpenzimeve që duhet të financohen (duke përfshirë Taksat)
(1) Mallrat, shërbimet jo të konsulencës, shërbimet e konsulencës, kostot operative dhe trajnimit sipas Projektit	1,428,571	100%
SHUMA TOTALE	1,428,571	



3.02. **Kushtet e Tërheqjes.** Pavarësisht dispozitave të Seksionit 3.01 të kësaj Marrëveshjeje, asnjë tërheqje nuk mund të bëhet për pagesat e bëra para datës së kësaj Marrëveshjeje.

3.03. **Periudha e Tërheqjes.** Data e Mbylljes është data 31 dhjetor 2025.

Neni IV

Përfaqësuesit e Marrësit; Adresat

4.01. **Përfaqësuesi i Marrësit.** Përfaqësuesi i Marrësit, i përmendur në Seksionin 7.02 të Kushteve Standarde, është Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

4.02. **Adresa e Marrësit.** Për qëllime të Seksionit 7.01 të Kushteve Standarde:

a) Adresa e Marrësit është:

Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Nr. 3
Tiranë, Shqipëri; dhe

b) Adresa elektronike e Marrësit është:
sekretariamin@financa.gov.al

4.03. **Adresa e Bankës.** Për qëllime të Seksionit 7.01 të Kushteve Standarde:

a) Adresa e Bankës është:

Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim dhe Shoqata Ndërkombëtare për Zhvillim
1818 H Street, N.W.
Washington, D.C. 20433
United States of America; dhe

b) Adresa Elektronike e Bankës është:

Teleks: Faks:
248423 (MCI) ose 1-202-477-6391
64145 (MCI)

VENDIM

Nr. 265, datë 29.4.2022

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.548, DATË 27.7.2016, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E KRITEREVE, RREGULLAVE DHE TË PROCEDURAVE PËR PËRFITIMIN E PENSIONEVE SHTETËRORE SUPLEMENTARE TË PERSONAVE QË KRYEJNË FUNKSIONE KUSHTETUESE DHE TË PUNONJËSVE TË SHTETIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 1, 15 e 17, të ligjit nr.8097, datë 21.3.1996, “Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 18, e vendimit nr.548, datë 27.7.2016, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“18) Personat e interesuar për të përfituar pagesë kalimtare apo pensione shtetërore suplementare duhet të paraqesin, përmes portalit qeveritar “e-Albania”, kërkesën për përfitim, ndërsa dokumentet origjinale dërgohen përmes shërbimit postar pranë Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore ku kanë vendbanimin.”.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj

**VENDIM****Nr. 266, datë 29.4.2022**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA
NË VENDIMIN NR.17, DATË 15.1.2020,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE,
“PËR PROCEDURAT, KRITERET
DHE RREGULLAT PËR ZBATIMIN E
PROGRAMEVE TË NXITJES SË
PUNËSIMIT NËPËRMJET PUNËSIMIT,
FORMIMIT NË PUNË DHE
PRAKTIKAVE PROFESIONALE”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 11, të ligjit nr.15/2019, “Për nxitjen e punësimit”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.17, datë 15.1.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Në kreun II, “Kriteret e aplikimit”, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

i. Në pikën 1, fjalët “... 3 (tre) ...” ndryshohen me “... 1 (një) ...”;

ii. Në shkronjën “P”, të pikës 4, fjalët “... 4 (katër) ...” ndryshohen me “... 2 (dy) ...”;

iii. Në pikën 5, pas fjalëve “... aplikojnë në ...” shtohen “... një ose ...”.

b) Në pikën 3, të kreut III, “Programet, përfituesit dhe mbështetja”, bëhen këto ndryshime:

i. Shkronja “a” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“a) Programi i praktikave profesionale ka si qëllim të garantojë tranzicion të shpejtë në tregun e punës, në të njëjtën fushë ose në një fushë të ngjashme me atë, në të cilën ka studiuar i diplomuari ose nxënësit e diplomuar në shkollat e mesme profesionale publike apo private, për një kohëzgjatje 6-mujore.”.

ii. Në shkronjën “b”, fjalët “... 24 (njëzet e katër) ...” ndryshohen me “... 36 (tridhjetë e gjashtë) ...”.

c) Fjalja hyrëse e pikës 2, të kreut IV, “Rregullat dhe procedurat e zbatimit”, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Punëdhënësit paraqesin kërkesën për përfshirjen në program nëpërmjet portalit “e-

Albania”, duke ngarkuar dokumentacionin e mëposhtëm: “.

ç) Kudo në përmbajtje të vendimit, fjalët “... aplikues/aplikim ...” ndryshohen me “... kërkes/kërkesë ...”.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj**

VENDIM**Nr. 267, datë 29.4.2022**

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN
NR.837, DATË 28.10.2020, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR PROCEDURAT,
KRITERET E RREGULLAT PËR
OFRIMIN E SHËRBIMEVE
TË PUNËSIMIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 7, të ligjit nr.15/2019, “Për nxitjen e punësimit”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.837, datë 28.10.2020, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

a) Pika 1, e kreut III, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Çdo punëdhënës, që kërkon të përfitojë shërbime nga zyra përkatëse e punësimit, regjistrohet nëpërmjet portalit *e-Albania*, duke plotësuar formularin përkatës, ku përfshihet edhe deklarimi për kontrollin e të dhënave.”;

b) Kudo në përmbajtjen e vendimit, fjala “aplikim” zëvendësohet me fjalën “kërkesë”.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj**



VENDIM

Nr. 268, datë 29.4.2022

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA
NË VENDIMIN NR.453, DATË 3.7.2019,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
MASËN E SUBVENCIONIT TË
INTERESAVE TË KREDISË DHE
PROCEDURËN E DHËNIES SË TIJ PËR
FAMILJET, QË PËRFITOJNË BANESË
ME KOSTO TË ULËT, ME KREDI TË
LEHTËSUARA NGA SHTETI”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 47, të ligjit nr.22/2018, “Për strehimin social”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.453, datë 3.7.2019, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në pikën 3 bëhen ndryshimet, e mëposhtme:

a) Në fjalinë e parë, pas fjalës “... të shpronësuara ...” shtohen fjalët “... dhe për familjet e punonjësve, që kanë humbur jetën në krye apo për shkak të detyrës ...”;

b) Në fund të fjalisë së dytë shtohen fjalët “... program, i cili zbatohet për këto kategori familjesh nëpërmjet Entit Kombëtar të Banesave (EKB), si institucion publik i ngarkuar për zbatimin e këtij programi.”.

2. Pas pikës 3 shtohet pika 3/1, me këtë përmbajtje:

“3/1. Kufiri maksimal i kreditimit, sipas strukturës së familjes, llogaritet sipas formulës në lidhjen 1, bashkëlidhur këtij vendimi, bazuar në:

a) çmimet mesatare të shitblerjes së banesave në treg, sipas aktit nënligjor në fuqi, që përcakton vlerat mesatare të shitblerjes së banesave në treg;

b) sipërfaqen e apartamentit, që përfiton familja, bazuar në normat e strehimit në fuqi.”.

2. Në fund të shkronjës “b”, të pikës 8, shtohet fjalia, me këtë përmbajtje:

“Disbursimi i fondeve për subvencionim në këtë rast bëhet nëpërmjet Entit Kombëtar të Banesave.”.

4. Pika 16 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“16. Individit/familja, që kërkon për subvencionimin e interesave të kredisë, ngarkon në

portalin qeveritar “e-Albania”, në sistemin e banesave sociale, dokumentacionin, që lidhet me plotësimin e kushteve të përgjithshme. Lista e familjeve, që plotësojnë kushtet e subvencionimit të interesave të kredisë miratohet me vendim të këshillit të njësisë së vetëqeverisjes vendore.”.

5. Pas pikës 16 shtohet pika 16/1, me këtë përmbajtje:

“16/1. Familjet qiramarrëse në ish-pronë private ngarkojnë në portalin qeveritar “e-Albania”, në sistemin e Entit Kombëtar të Banesave, dokumentacionin, sipas shkronjës “b”, të pikës 18, të këtij vendimi. Miratimi i listave të familjeve, që plotësojnë kushtet për të përfituar kredi me interes 0 (zero) % miratohen me vendim të komisionit të kredisë të ngritur pranë EKB-së.”.

6. Në pikën 17 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Pas fjalëve “... me vendim të këshillit të njësisë së vetëqeverisjes vendore ...” shtohen “... apo me vendim të komisionit të kredisë të ngritur pranë EKB-së ...”;

b) Fjala “... përfitimin ...” zëvendësohet me “... dhënien ...”.

7. Pika 18 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“18. Për efekt të përfitimit të subvencionimit të interesave të kredisë, veprohet, si më poshtë vijon:

a) Individët/familjet, që do të miratohen me vendim të këshillit të njësisë vetëqeverisjes vendore, paraqesin kërkesën në portalin qeveritar “e-Albania”, në sistemin e banesave sociale, duke ngarkuar deklaratën për dhënien e pëlqimit për përdorimin e të dhënave personale, si dhe për të ngarkuar dokumentacionin e përcaktuar në pikën 16, të vendimit nr.384, datë 12.6.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”;

b) Individët/familjet me statusin e qiramarrësit në ish-pronë private, të cilët përfitojnë kredi me 0 (zero) % interes në vit, paraqesin kërkesën në portalin qeveritar “e-Albania”, në sistemin e Entit Kombëtar të Banesave, duke ngarkuar dokumentacionin, si më poshtë vijon:

i. Autorizim ose dokument të lëshuar nga ish-Komiteti Ekzekutiv i lagjes/Këshilli Popullor i lagjes;

ii. Certifikatë apo vërtetim pronësie në favor të pronarit ose vendim gjykatë, në të cilin vërtetohet se prona i është kthyer pronarit të ligjshëm dhe



qytetari është i pastrehë; vërtetim negativ nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës përkatëse, që, në emër të kryefamiljarit dhe anëtarëve të tjerë të familjes, sipas certifikatës të gjendjes familjare të datës 1.12.1992, nuk figuron banesë e regjistruar ose në proces regjistrimi;

iii. Vërtetim nga organet tatimore se asnjë anëtar i familjes, që përfiton kredi të lehtësuar, nuk është subjekt i tatimit mbi vlerën e shtuar, si biznes i madh;

iv. Certifikatë e gjendjes familjare të datës 1 dhjetor 1992 dhe ajo aktuale;

v. Adresa e banesës dhe emri i pronarit të banesës.

c) Familjet e punonjësve, që kanë humbur jetën në krye apo për shkak të detyrës, të cilët përfitojnë kredi me 0 (zero) % interes në vit, plotësojnë dokumentacionin, si më poshtë vijon:

i. Certifikatë e gjendjes familjare aktuale;

ii. Vërtetim negativ nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës e vendit ku banojnë, që, në emër të kryefamiljarit dhe të anëtarëve të tjerë të familjes, nuk figuron pronë e regjistruar apo në proces regjistrimi;

iii. Lista e miratuar nga Ministria e Brendshme dhe e shoqëruar me dokumentacionin e plotësuar i përcillet Entit Kombëtar të Banesave, i cili shqyrton dokumentacionin për të vazhduar me procedurat e kreditimit.”

8. Në pikën 19, pas fjalës “... vendore ...” shtohen fjalët “... ose me vendim nga komisioni përkatës i ngritur pranë EKB-së, në varësi të programeve të kreditimit që zbatohen ...”.

9. Në fund të fjalisë së parë, të pikës 23, shtohen fjalët “... si dhe sipas listës së dërguar nga EKB-ja.”.

10. Pika 24 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“24. Individët/familjet e miratuara me vendim të këshillit të njësisë së vetëqeverisjes vendore, për të përfituar nga programi i kreditimit, duhet të kujdesen për gjetjen e blerjen e një banese në treg të lirë. Afati maksimal për kryerjen e procedurave të përfitimit të kredisë është 18 (tetëmbëdhjetë) muaj nga data e protokollimit të listës emërore pranë institucionit, që monitoron subvencionimin e interesave të kredisë. Individ/familja, që ende nuk ka gjetur banesën, njofton nëpërmjet postës elektronike, çdo 6 (gjashtë) muaj, institucionin financiar dhe, nëpërmjet portalit qeveritar “e-Albania”, institucionin që monitoron subvencionim

e kredisë për shfaqjen e interesit dhe pamundësisë së tij për gjetjen e banesës. Me mosdërgimin e këtij informacioni çdo 6 (gjashtë) muaj, veprohet sipas pikës 12, të këtij vendimi. Njësitë e vetëqeverisjes vendore njoftojnë menjëherë individët/familjet e miratuara për fillimin e afatit, brenda të cilit duhet të kryejnë procedurat për përfitim kredisë.”.

11. Pika 25 shfuqizohet.

12. Fjalja hyrëse e pikës 26 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Në rast se familja nuk paraqet kërkesë për shtyrje, sipas afateve të përcaktuara në pikën 24, të këtij vendimi, veprohet, si më poshtë vijon:”.

13. Pas pikës 26 shtohet pika 26/1, me këtë përmbajtje:

“26/1. Individët/familjet e miratuara për të përfituar kredi me interes 0 (zero) %, duhet të kujdesen për gjetjen e blerjen e një banese në treg të lirë. Këto familje vazhdojnë të qëndrojnë në listë pritjeje deri në kryerjen e procedurave të kreditimit dhe të lidhjes së kontratës me institucionin financiar për përfitimin e kredisë.”.

14. Pika 28 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“28. “Lista e individëve/familjeve, e miratuar me vendim të këshillit të njësisë së vetëqeverisjes vendore, sipas lidhjes 2 bashkëlidhur këtij vendimi, i dërgohet institucionit financiar me të cilin është nënshkruar marrëveshja.”.

15. Pas pikës 28 shtohet pika 28/1, me këtë përmbajtje:

“28/1. Lista e familjeve qiramarrëse, që banojnë në banesa, pronë e subjekteve të shpronësuar, e miratuar me vendim të komisionit të vlerësimit në EKB, i dërgohet institucionit financiar me dokumentacionin, si më poshtë vijon:

a) Kopje e certifikatës familjare të datës 1 dhjetor 1992;

b) Emri, atësia, mbiemri i kryefamiljarit, struktura e apartamentit dhe vlera e kredisë, që përfiton familja, sipas certifikatës familjare të datës 1 dhjetor 1992;

c) Në rastet kur kryefamiljari, emri i të cilit i është përcjellë institucionit financiar, sipas shkronjës “a”, të kësaj pike, ka ndërruar jetë, institucioni financiar vijon me procedurat e përfitimit të kredisë, duke pasur parasysh certifikatën familjare të datës 1 dhjetor 1992, të vënë në dispozicion nga EKB-ja.”.

16. Pas shkronjës “b”, të pikës 36, shtohen shkronjat “c” e “ç”, me këtë përmbajtje:



“c) mangësi apo të meta në dokumentacionin e dosjes së familjes përfituese;

ç) subvencionimi i interesave ndërpritet edhe në rastet kur të ardhurat e individit/familjes, që nga momenti i miratimit të tij nga këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe deri në miratimin e kredisë nga institucioni financiar janë rritur më shumë se 1.2 e të ardhurave fillestare. Në rast se institucioni financiar nga dokumentacioni konstaton se individi/familja ka raportuar të ardhura më të larta sesa niveli i përcaktuar në ligjin nr.22/2018, “Për strehimin social”, njofton, brenda 3 (tri) ditëve pune institucionin zbatues. Për zbatimin e këtij detyrimi nga institucioni financiar, institucioni që zbaton programin i dërgon këtij të fundit nivelin e të ardhurave maksimale për çdo strukturë familjare sipas qarqeve.”.

17. Në pikën 38, pas fjalëve “... ministria përgjegjëse për strehimin ... “ shtohet emërtimi “Enti Kombëtar i Banesave”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj

LIDHJA 1- Formula e llogaritjes së masës së kredisë

Formula për llogaritjen e masës së kredisë është, si më poshtë:

$$K_{\max} = S \times V_m$$

Ku:

Kmax – Vlera maksimale e kredisë;

S – është sipërfaqja e apartamentit, që përfiton familja sipas vendimit nr.301, datë 15.4.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për normat e strehimit, si

dhe kushtet e standardet për banesat sociale me qira që blihen në treg dhe banesat me kosto të ulët”;

Vm – është vlera mesatare e apartamentit në treg, sipas udhëzimit nr.3, datë 28.12.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave”.

Shembull

Të dhënat dhe burimi i informacionit

1- Sipërfaqet e apartamenteve (pika 15, tabela nr.2 e vendimit nr.301, datë 15.4.2020, të Këshillit të Ministrave):

Nr.	Struktura e familjes (nr. i personave)	Struktura e ap.	Sipërfaqe apartamenti
1	1-2	G	45
2	3	1+1	55
3	4	2+1	81
4	5-6	3+1	100

2- Qyteti Tiranë

3- Familje me 4 persona madhorë

4- Sipërfaqja e apartamentit që përfiton familja është **81m²**.

5- Vlera mesatare e shitblerjes së banesave në treg, sipas udhëzimit nr.3, datë 28.12.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave”, për qytetin e Tiranës është **89,137 lekë/m²** sipërfaqe shfrytëzimi.

6- Vlera maksimale e kreditimit për familjen në fjalë është $81 \times 89,137 = 7,220,097$ lekë.



LIDHJA 2– Formati i listës emërore

Nr. rendor	Emri/Atësia/Mbiemri	Përbërja familjare	Struktura e apartamentit që përfiton	Kushtet e strehimit (shkronja “a”, e nenit 16)	Kushtet familjare (shkronja “b”, e nenit 16)	Kushtet sociale (shkronja “c”, e nenit 16)	Të ardhurat mujore neto të familjes	Punësimi	Vlera maksimale e kredisë që përfiton
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10

Shënim:

Lista emërore duhet të jetë e shtypur (jo e shkruar me shkrim dore);

1- Çdo faqe e listës emërore duhet të ketë vulën e Këshillit Bashkiak;

2- Shkresa përcjellëse dërgohet me firmë të kryetarit të Bashkisë Bankave, me të cilat është lidhur marrëveshje bashkëpunimi.

3- Shkresa përcjellëse duhet të përmbajë numrin total të listës së familjeve, që i dërgohen bankës. Kopje e shkresës përcjellëse i dërgohet dhe ministrisë përgjegjëse për strehimin;

4- Në kolonën 2 vihet emri i kryefamiljarit/personit që kërkon;

5- Në kolonën 3, përbërja e familjes sipas ç=certifikatës së gjendjes familjare;

6- Në kolonën 4, struktura e apartamentit që përfiton sipas normave të strehimit në fuqi;

7- Në kolonat 5, 6 e 7 vendoset një nga rastet e parashikuara në shkronjat “a”, “b” e “c”, të nenit 16, të ligjit nr.22/2018. “Për strehimin social”;

8- Në kolonën 8 vendosen vlerat sipas tabelës nr.2 për shumën e kredisë që përfiton individi/familja;

9- Në kolonën 9 vendosen statusi i punësimit të kryefamiljarit/kërkuesit:

a) e/i punësuar në shtet;

b) e/i punësuar në privat;

c) i vetëpunësuar;

ç) pronar biznesi i vogël, sipas legjislacionit tatimor.



VENDIM

Nr.269 , datë 29.4.2022

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.53, DATË 29.1.2004, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PROCEDURAT DHE MASËN E TRAJTIMIT TË VEÇANTË FINANCIAR TË PILOTËVE FLUTURUES NË PENSION”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 8, të ligjit nr.9128, datë 29.7.2003, “Për një trajtim të veçantë financiar të pilotëve fluturues në pension”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 1, e vendimit nr.53, datë 29.1.2004, të Këshillit të Ministrave, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Personi i interesuar, për efekt të llogaritjes, caktimit dhe pagesës së shtesës mbi pension, si trajtim i veçantë financiar, në zbatim të ligjit nr.9128, datë 29.7.2003, “Për një trajtim të veçantë financiar të pilotëve fluturues në pension”, paraqet kërkesë nëpërmjet portalit qeveritar “e-Albania”.”.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj

VENDIM

Nr. 270, datë 29.4.2022

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.535, DATË 8.7.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PROCEDURAT, KRITERET DHE RREGULLAT PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT TË PUNËVE PUBLIKE NË KOMUNITET”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 11, të ligjit nr.15/2019, “Për nxitjen e punësimit”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.535, datë 8.7.2020, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

a) Fjalë hyrëse e pikës 3, të kreut V, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Punëdhënësit paraqesin kërkesën për përfshirjen në program nëpërmjet portalit qeveritar “e-Albania”, me dokumentacionin e mëposhtëm: ...”.

b) Kudo në përmbajtjen e vendimit, fjala “aplikim” zëvendësohet me “kërkesë”.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj

VENDIM

Nr. 271 , datë 29.4.2022

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.505, DATË 10.6.2015, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR ORGANIZIMIN, FUNKSIONIMIN DHE SHPËRBLIMIN E KOMISIONEVE EPRORE TË CAKTIMIT TË AFTËSISË PËR PUNË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 39/2, pika 4, e 39/3, pika 5, të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shkronja “a”, e pikës 6, të vendimit nr.505, datë 10.6.2015, të Këshillit të Ministrave, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“a) Ankimi në komisionin epror bëhet nëpërmjet portalit qeveritar “e-Albania”, sipas formularit tip të dhënë në aneksin 3, bashkëlidhur këtij vendimi.”.



2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj

VENDIM
Nr. 272, datë 29.4.2022

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.651, DATË 14.9.2016, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR.10139, DATË 15.5.2009, “PËR PENSIONET SHTETËRORE SUPLEMENTARE TË PUNONJËSVE TË UNIVERSITETEVE, TË SHKOLLAVE TË LARTA, QENDRËS SË STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE, AKADEMISË SË SHKENCAVE DHE TË GJITHA INSTITUCIONEVE TË TJERA KËRKIMORE PUBLIKE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË, TË CILËT KANË TITUJ SHKENCORË”, TË NDRYSHUAR”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 7, 12 e 15, të ligjit nr.10139, datë 15.5.2009, “Për pensionet shtetërore suplementare të punonjësve të universiteteve, të shkollave të larta, Qendrës së Studimeve Albanologjike, Akademisë së Shkencave dhe të gjitha institucioneve të tjera kërkimore publike në Republikën e Shqipërisë, të cilët kanë tituj shkencorë”, të ndryshuar”, dhe ligjit nr.80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 7, e vendimit nr.651, datë 14.9.2016, të Këshillit të Ministrave, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“7. Personat e interesuar për të përfituar pension suplementar sipas ligjit nr.10139, datë 15.5.2009, të ndryshuar, paraqesin, nëpërmjet portalit qeveritar “e-Albania”, kërkesën për përfitim

dhe dërgojnë, nëpërmjet shërbimit postar, pranë Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore, ku kanë vendbanimin, dokumentet shoqëruese, si më poshtë vijon:

a) Fotokopje të noterizuar të dëshmisë për dhënien e titullit ose vërtetim për dhënie titulli nga komisioni i kualifikimit shkencor apo nga komisioni i vlerësimit të titujve;

b) Vërtetim, lëshuar nga qendra e punës, për pagën referuese, si dhe kohën e gëzimit të titullit, në zbatim të ligjit nr.10139, datë 15.5.2009, të ndryshuar.”.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj

VENDIM
Nr. 274 , datë 29.4.2022

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.477, DATË 25.7.2012, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PROCEDURAT DHE MASËN E TRAJTIMIT TË VEÇANTË FINANCIAR TË PILOTËVE DHE TEKNIKËVE FLUTURUES ME HELIKOPTER, NË PENSION, NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË POLICISË SË SHTETIT DHE GARDËN E REPUBLIKËS”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 1, 3 e 8 të ligjit nr.9128, datë 29.7.2003, “Për një trajtim të veçantë financiar të pilotëve fluturues, në pension”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 1, e vendimit nr.477, datë 25.7.2012, të Këshillit të Ministrave ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Punonjësi i Policisë së Shtetit dhe i Gardës së Republikës, në funksionet pilot dhe teknik fluturues të helikopterëve, që trajtohen nga ligji nr.9128, datë 29.7.2003, “Për një trajtim të veçantë



financiar të pilotëve fluturues, në pension”, të ndryshuar, me daljen në pension, plotëson kërkesën nëpërmjet portalit qeveritar “e-Albania”.”.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj

VENDIM
Nr. 275 , datë 29.4.2022

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.644, DATË 16.6.2010, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURËS DHE TË MASËS SË TRAJTIMIT TË VEÇANTË FINANCIAR TË PILOTËVE E TË TEKNIKËVE FLUTURUES TË NJËSISË SË TRANSPORTIT MJEKËSOR ME HELIKOPTER, NË PENSION”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 8, të ligjit nr.9128, datë 29.7.2003, “Për një trajtim të veçantë financiar të pilotëve fluturues, në pension”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 1, e vendimit nr.644, datë 16.6.2010, të Këshillit të Ministrave, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Piloti/tekniku i interesuar, për efekt të llogaritjes, caktimit dhe pagesës së shtesës mbi pension, si trajtim i veçantë financiar, plotëson kërkesën për përfitim nëpërmjet portalit qeveritar “e-Albania”.”.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj

VENDIM

Nr. 276, datë 29.4.2022

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.721, DATË 11.11.2019, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E DOKUMENTACIONIT, SHUMËS VJETORE TË TRANSFERTËS NGAXHETI I SHTETIT DHE PROCEDURAVE TË FINANCIMIT TË FONDIT TË SIGURIMEVE SHOQËRORE PËR TRAJTIMIN FINANCIAR SUPLEMENTAR TË PUNONJËSVE QË KANË PUNUAR NË MINIERA NË NËNTOKË, TË PUNONJËSVE TË INDUSTRIËS SË NAFTËS E TË GAZIT DHE TË PUNONJËSVE QË KANË PUNUAR NË METALURGJI”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8 e 13, të ligjit nr.29/2019, “Për trajtimin financiar suplementar të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë, të punonjësve të industrisë së naftës e të gazit dhe të punonjësve që kanë punuar në metalurgji”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr.721, datë 11.11.2019, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Për të përfituar pension për shkak të profesionit, personat që plotësojnë kushtet sipas ligjit, plotësojnë kërkesën nëpërmjet portalit qeveritar “e-Albania” dhe dërgojnë nëpërmjet shërbimit postar pranë Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore ku kanë vendbanimin, dokumentet shoqëruese, si më poshtë vijon:

a) Librezën e punës të plotësuar në të gjitha rubrikat, sipas llojit të punës;

b) Vërtetimin për bazën e vlerësuar për periudhat e punësimit nga data 1.1.1994 deri në datën e ndërprerjes së marrëdhënieve financiare nga puna ose vetëpunësimi;

c) Vërtetimin e posaçëm të konfirmimit të llojit të punës në profesionet e vështira, sipas përcaktimeve në këtë ligj dhe në vendimin nr.526,



datë 20.12.1958, të Këshillit të Ministrave, “Për ndarjen e punëve në kategori, për efekt pensioni”, i lëshuar nga ndërmarrja ku personi ka qenë i punësuar, kur subjekti është aktiv ose nga dokumentacioni arkivor i sigurimeve shoqërore;

c) Çdo dokumentacion tjetër që vërteton llojin dhe periudhën e punës për efekt pensioni, i njohur për zbatimin e dispozitave të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.”.

2. Pika 2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“2. Për të përfituar shtesë mbi pensionin, sipas nenit 4, të ligjit nr.29/2019, “Për trajtimin financiar suplementar të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë, të punonjësve të industrisë së naftës e të gazit dhe të punonjësve që kanë punuar në metalurgji”, personat që plotësojnë kushtet e neneve 3 e 6, të këtij ligji, dhe janë përfitues të pensionit sipas ligjit nr.4171, datë 13.9.1966, “Mbi sigurimet shoqërore shtetërore të Republikës Popullore të Shqipërisë”, të ndryshuar, ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të pensionit të parakohshëm, sipas nenit 96, të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, të ndryshuar, si dhe sipas ligjit nr.150/2014, “Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera, në nëntokë”, kur data e lindjes të së drejtës për pension është deri më 31.12.2014, plotësojnë kërkesën nëpërmjet portalit qeveritar “*e-Albania*” dhe dërgojnë nëpërmjet shërbimit postar pranë Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore, ku kanë vendbanimin, çdo dokumentacion tjetër që vërteton llojin dhe periudhën e punës, për efekt pensioni, i njohur për zbatimin e dispozitave të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.”.

II. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

Arben Ahmetaj

VENDIM

Nr. 277, datë 29.4.2022

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.793, DATË 24.9.2010, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR.10142, DATË 15.5.2009, “PËR SIGURIMIN SHOQËROR SUPLEMENTAR TË USHTARAKËVE TË FORCAVE TË ARMATOSURA, TË PUNONJËSVE TË POLICISË SË SHTETIT, TË GARDËS SË REPUBLIKËS, TË SHËRBIMIT INFORMATIV TË SHTETIT, TË POLICISË SË BURGJEVE, TË POLICISË SË MBROJTJES NGA ZJARRI DHE TË SHPËTIMIT E TË PUNONJËSVE TË SHËRBIMIT TË KONTROLLIT TË BRENDSHËM NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, 4, 5, pika 1, 11, 22, 23, pika 1, 26 e 29, të ligjit nr.10142, datë 15.5.2009, “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit e të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shkronja “A”, e kreut III, të vendimit nr.793, datë 24.9.2010, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“A. Personi, të cilit i lind e drejta për përfitime pas datës së hyrjes në fuqi të ligjit nr.10142, datë 15.5.2009, paraqet kërkesë përmes portalit qeveritar “*e-Albania*”.”.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

Arben Ahmetaj

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2022

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 208 lekë